

INVESTITORI

“Durimi” SH.P.K .

Strazhë, Novo Berdë

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
IMPIANTIN E SHFRYTËZIMIT , PËRPUINIMIT, THERMIMIT
DHE SEPERIMIT TË GURIT TË GËLQEROR , NGA KOMPANIA
“ DURIMI” SH.P.K ., STRAZHË , KOMUNA E NOVO BERDËS**

Novo Berdë, Shkurt 2026

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR IMPIANTIN E , NGA
KOMPANIA “ DURIMI” SH.P.K ., STRAZHË , KOMUNA E NOVO BERDËS

Ngastra kadastrale e fshatit Strazhë Komuna Novo Berdë Qertifikata nr.00673-1dhe 00673-2
ngastrat P-72403058-00673-1 dhe P-72403058-00673-2, numri i certifikates 128/2024 dt
05.02.2024 .

INVESTITORI	
Aplikuesi:	Armend Prekadeni
Investitori:	“Durimi” SH.P.K .
Adresa:	Vasilevë , P.N., Glllogoc
Lokacioni i Fabrikës:	Strazhë , Novo Berdë
Tel:	+383 44170911 & +383 49 777483
Email:	samibheta@hotmail.com & durimishpk@hotmail.com

Kompania “*DURIMI*”*Sh.p.k.* Vailevë-Glllogoc, për kryerjen e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe gurëthyesin me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në lokalitetin Strazhë, zona kadastrale Strazhë, komuna e Novo Berdës, autorizon Sami Heten me nr. te licences9/16, e vlefshme prej 19.06.2020 deri me 19.06.2025:

Investitori: „Durimi ” Sh.p.k. Vailevë-Glllogoc

Pronarë: Armend Prekadeni

Vv

Hartuar nga përsone i Licencuar

Sami Heta_____

Tel:+38344170911

Email: samibheta@hotmail.com

Përmbajtja

1. HYRJE	6
2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM -së.....	6
3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR	8
3.1. Kategoria e Projektit të Propozuar	8
3.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit	8
3.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit	8
3.5. Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme.....	23
3.6. Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik.....	23
3.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave	24
3.8. Programi kohor i ndërtimit dhe operimit të projektit dhe faza e rehabilitimit pas përfundimit të funksionimit.....	24
3.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme	28
3.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave	29
3.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin	29
3.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	29
4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR.....	30
4.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti	30
4.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit	30
4.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti	36
4.4. Paraqitje e karakteristikave pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit	37
4.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë.....	42
4.6. Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik	42
4.7. Karakteristikat natyrore.....	42
4.8. Karakteristikat themelore të peizazhit	42
4.9. Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike	43
4.10. Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike	43

4.11. Të dhënat për objektet ekzistuese.....	44
4.12. Në Zonat me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit	45
5. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR.....	45
5.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor.....	45
6. PËRSHKRIMI I ALTERNATIV A VE TË PROJEKTIT.....	47
6.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme.....	47
6.2. Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës së propozuar	48
6.3. Vendndodhja ose rruga.....	48
6.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut	48
6.5. Proceset dhe teknologjia e prodhimit	48
6.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit	49
6.7. Plani i lokacionit.....	49
6.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit.....	49
6.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit	49
6.10. Madhësia e lokacionit ose objektit	50
6.11. Vëllimi i prodhimit.....	50
6.12. Kontrolli i ndotjes.....	50
6.13. Trajtimin e mbeturinave	50
6.14. Infrastruktur a rrugore dhe qasja	50
6.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit.....	50
6.16. Trajnimi.....	50
6.17. Monitorimi	50
6.18. Planet për situata emergjente.....	50
6.19. Demolimi dhe rehabilitimi	50
6.20. Plani për menaxhimin e mjedisit	50
6.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim.....	51
7. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS	51
7.1.Ndikimet në ajër gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit	52
7.2. Ndikimet në tokë gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit	52
7.3. Ndikimet në ujë gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit	53
7.4. Ndikimi në pejzazh gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit.....	53
7.5.Ndikimi në florë dhe faunë gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit.....	54

7.6.Ndikimi në nivelet e zhurmës gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit.....	54
7.7.Ndikimi social gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit	54
7.8.Ndikimet Kumulative.....	55
7.9.Mbeturinat dhe masat e marrura gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit.....	55
8. PËRSHKRIMI I MASA VE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS.....	56
8.1.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....	57
8.2.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë.....	57
8.3.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë.....	57
8.4.Masat për mbrojtje nga zhurma.....	58
8.5.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh	59
8.6.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në florë dhe faunë	60
8.7. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	60
9. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	60
9.1.Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis	60
9.2.Gjendja mjedisore para fillimit të projektit	61
9.3.Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis	61
9.4.Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar	61
9.5.Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera.....	61
9.6.Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera.....	62
9.7.Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis	62
10. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR.....	62
10.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit	62
10.2. Pajtushmeria me pëlqim mjedisor	63
11. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT	64
11.1. Informacionet dhe karakteristikat shtesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së	64
12. BURIMET E TË DHËNAVE.....	64
12.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet	64

1. HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe aktiviteteve tjera minerare është punuar në bazë të kërkesës së Armend Prekadani drejtor i bordit të kompanisë “DURIMI” shpk Vasilevë, komuna e Gillogocit, për të aplikuar për Pëlqim Mjedisor, i cili është një dokument i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për marrjen e lejes për eksploatim të gurit gëlqeror në lokalitetin Strazhë komuna e Novo Berdë.

Në raport do të analizohen ndikimet në mjedis të tërë proceseve teknologjike për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe aktiviteteve tjera minerare, duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do të ushtrohet kjo veprimtari dhe rreth tij.

Duke analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe aktiviteteve tjera minerare, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inzhinjeroko- teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, behet hartimi i raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin eksploatim i gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare dhe mjedis. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së realizimit të procesit teknologjik për eksploatimin e gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare, dhe pas përfundimit të projektit, për eksploatimin e gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare në lokalitetin e lartcekur.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM -së

Bazuar në karakteristikat e impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror, si dhe në natyrën e aktivitetit industrial të planifikuar, ky projekt është subjekt i procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Baza kryesore ligjore për hartimin e këtij Raporti të VNM -së është Ligji Nr. 08/L -181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis . Sipas Shtojcës 1 , paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L -181, që përfshin Gurore dhe miniera të

hapura, në sipërfaqe më të madhe se pesë (5) ha, nxjerrje të torfës, në sipërfaqe më të madhe se dhjetë (10) ha ose nxjerrja e më tepër se pesëmbëdhjetëmijë (15.000) tonë/vit. I nënshtrohen detyrimit vlerësimit të ndikimit në mjedis, për shkak të potencialit të tyre për ndikime në ajër, tokë, ujë, zhurmë dhe mjedisin përreth. Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante të Republikës së Kosovës, të cilat rregullojnë aspektet mjedisore, teknike dhe të sigurisë së projektit, si më poshtë: Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L -025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L -181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L -060;
- Ligji nr. 08/l -071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l -060 për mbeturina
- Ligji për Ndërtimin Nr. 04 / L -110;
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L -174;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L -102;
- Ligji Nr. 08/L -261 për Mbrojtje nga Zjarri;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L -025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L -233;

Udhëzimet Administrative:

➤ Udhëzim Administrativ (Mmphi) Nr.04/2025 për Pëmbajtjen , Metodologjinë dhe Përputhshmërinë e Raportit me Kërkesat Ligjore , Praktikrat e Zbatueshme dhe Aspektet e Tjera Teknike Të Raportit

➤ Udhëzim Administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;

➤ Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;

Kjo kornizë ligjore dhe nënligjore shërben si bazë për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore që mund të shkaktohen nga ndërtimi dhe operimi i impiantit për përpunimin e gurit gëlqeror, duke siguruar që projekti të zhvillohet në përputhje me standardet mjedisore dhe kërkesat për mbrojtjen e shëndetit publik.

3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

3.1. Kategoria e Projektit të Propozuar

Projekti i propozuar për ndërtimin dhe operimin e VB e gëlqerorëve shfrytëzim për përpunimin, thërrmimin dhe së projekteve industriale për përpunimin e materialeve minerare inerte. Bazuar në natyrën e aktivitetit, karakterin industrial të procesit dhe kapacitetin e planifikuar të impiantit, projekti përfshin procese mekanike të përpunimit, thërrmimit, seperimit dhe klasifikimit të gurit gëlqeror për prodhimin e fraksioneve të ndryshme të agregateve për përdorim në ndërtim dhe infrastrukturë. Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L -181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, projekti klasifikohet në Shtojcën 1, në kuadër të industrisë ekstraktuese dhe përpunimit të materialeve minerare, çka nënkupton se i nënshtrohet detyrimisht procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Ky klasifikim bazohet në faktin se aktivitetet e përpunimit të gurit gëlqeror kanë potencial për ndikime të rëndësishme mjedisore, veçanërisht në aspektin e krijimit të pluhurit, zhurmës, ndikimeve në tokë dhe përdorimit të burimeve natyrore. Duke marrë parasysh shtrirjen hapësinore të projektit në lokalitetin Strazhë, Komuna e Novo Berdës, si dhe nevojën për infrastrukturë përcjellëse dhe zona funksionale për depozitimin e materialeve, projekti konsiderohet me ndikim potencial mjedisor kryesisht gjatë fazës së ndërtimit dhe gjatë operimit intensiv të impiantit. Megjithatë, këto ndikime janë të karakterit të menaxhueshëm dhe të kontrollueshëm përmes zbatimit të masave teknike dhe organizative të parashikuara në këtë raport. Në këtë kontekst, projekti i propozuar përfaqëson një aktivitet industrial të domosdoshëm për furnizimin e tregut me materiale ndërtimore, i cili do të zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore mjedisore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

3.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Lokaliteti ku planifikohet të kryhet eksplati i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, për realizimin e projektit përfshijnë përgatitjen e terrenit në lokacionin e paraparë, heqjen e masës durore, dhe humusit, nivelimin e sipërfaqes, rregullimin e zonave funksionale dhe ndërtimin e bazamenteve për vendosjen e pajisjeve teknologjike. Gjithashtu, parashihet ndërtimi i rrugëve të brendshme për qarkullimin e mjeteve transportuese, rregullimi i zonave për depozitimin e materialit të papërpunuar dhe atij të përpunuar, si dhe vendosja e infrastrukturës bazë teknike dhe energjetike.

3.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Shfrytëzimi seperimi dhe përpunimi i gurit gëlqeror dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare ku është planifikuar të bëhet zgjerimi i fushës eksplative ndodhen në pjesët e ngastrave

kadastrale Qertifikata nr.00673-1dhe 00673-2 ngastrat P-72403058-00673-1 DHE P-72403058-00673-2, numri i certifikates 128/2024 dt 05.02.2024 në Strazhë Komuna Novo Berdë me sip S=50546m2 me kulturë kullosë klasa 6 dhe mal kl 4

, është e përkufizuar me kufijtë dhe koordinatat e paraqitura ne dokumentacionin e bashkangjitur raportit të VNM-së dhe do te shënohen në vijim.

Pronari I kompanisë dhe Stafi I saj kanë punuar një kohë të gjatë në këtë veprimtari dhe është I interesuar që përvojen e ushtruar në këtë fushë deri më tani ta implementoj dhe përfeksionoj në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të gëlqërorëve veçanti dhe resurseve minerale në përgjithësi për nevojat e industrisë së ndërrimit në Kosovë. Për këtë arsye prej disa viteve është duke bërë përpjekje që të investoj në zhvillimin dhe nrgjerimin e kapaciteteve të reja për prodhimin e lëndëve të para në industrinë e ndërrimit, me një teknologji të avancuar, e cila ka si kriter kryesor ka mbrojtjen e mjedisit jetësor ku zhvillohen këto aktivitete.

Përzgjedhja e keti VB ne Stazhë te komunes se Novoberdes do të përfshijë këto tërësi tematike:

- Të dhënat e përgjithshme mbi vendburimin
- Nevojat ne rritje për fraksione
- Llogaritja e rezervave
- Vlerësimi I Vendburimit

Funksionimi i projektit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror bazohet në një proces mekanik të vazhdueshëm, i projektuar për të siguruar prodhim efikas të agregateve minerale në fraksione të ndryshme, në përputhje me kërkesat e tregut dhe standardet teknike në fuqi. Aktiviteti do të zhvillohet brenda një impianti industrial të organizuar në njësi funksionale të ndërlidhura, të cilat mundësojnë rrjedhë të kontrolluar të materialit nga pranimi deri te depozitimi i produktit përfundimtar. Materiali i papërpunuar i gurit gëlqeror pranohet në zonën e dedikuar të hyrjes dhe, përmes pajisjeve transportuese, dërgohet në fazën e përpunimit dhe thërrmimit primar, ku realizohet reduktimi fillestar i dimensioneve. Më pas materiali kalon në fazën e thërrmimit sekondar dhe, sipas nevojës, terciar, duke arritur madhësitë e përshtatshme për procesin e sep erimit. Funksionimi i impiantit do të realizohet në kushte të kontrolluara teknike, me përdorimin e sistemeve për reduktimin e pluhurit gjatë pikave kritike të procesit, si dhe me masa për uljen e zhurmës nga makineritë. Pajisjet janë të projektuara për operim të vazhdueshëm dhe mirëmbajtje pe

riodike, duke siguruar stabilitet të procesit dhe minimizim të ndërprerjeve operative. Kontrolli i procesit do të realizohet përmes mbikëqyrjes operative dhe procedurave të mirëmbajtjes, ndërsa organizimi i punës siguron funksionim të sigurt për personelin dhe respektim të kërkesave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit në punë. Funksionimi i projektit nuk përfshin procese kimike apo djegie dhe nuk gjeneron ujëra të ndotura nga procesi teknologjik, çka e bën ndikimin mjedisor të projektit të përqendruar kryesisht në aspekte mekanike, të cilat janë të menaxhueshme dhe të kontrollueshme. Në këtë mënyrë, projekti siguron prodhim të qëndrueshëm të materialeve minerare inerte, duke kombinuar efikasitetin teknik me zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore të përcaktuara në këtë raport.

3.4. Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit

PËRKUFIZIMI I GURORËS

Përkufizimi i fushës së shfrytëzimit në VB në Strazhë është bërë në bazë të

-Vetive fiziko- mekanike

-Elementeve hapësinore të VB

-Topografisë së terrenit

-Shkallës së hulumtimit

duke respektuar këta faktorë, gjatë definimit të konturit të gurores fundi i gurores

është përvetësuar në kuotën 700 dhe këto janë koordinatat e përcaktuara nga faza e hulumtimit

Koordinatat e Licences		
Nr.	Y	X
1	7533953.39	4710530.088
2	7534126.022	4710582.89
3	7533998.803	4710749.433
4	7533906.854	4710909.614
5	7533818.544	4710894.133
6	7533881.948	4710701.797
S= 5ha 00m²		

Kualiteti i gurit gëlqeror

Me qëllim të përcaktimit të kualitetit të gëlqerorëve nga ky VB. si dhe me qëllim të vlerësimit të aplikimit të tyre janë bërë analizat fiziko-mekanike, teknike si dhe kimike.

Nga analizat shohim se gëlqerorët e VB ka një gamë të gjer të përdorimit

ku në këtë rast konstatohet se mund të përdoren si:

- çakëll
- granit dhe gur dekorativ
- ndërtim të trupit të rrugës
- tampon
- materialit për drenim në fraksione të ndryshme,
- si material i nevojshëm për hidroteknik (veshje të kanaleve, impiant, diga)
- material i copëtuar për muratim etj

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Nga investitori është paraparë që kapaciteti vjetor i gurores të jetë 100000 [m³ /vit] fk. Sipas detyrës projektuese nevojat për fraksione të formacioneve shkëmbore të separuar me këtë projekt do të jetë: nga të dhënat e prezantuara më lartë, shtrohet nevoja e llogaritjes së kapaciteteve prodhuese të shkëmbive duke marrë parasysh humbjet. Investitori në detyrën Projektuese ka parapare kapacitetin vjetor të shkëmbive të jetë: $Q_{vjet}=100000 \text{ m}^3/\text{vit}$. Në përputhje me këtë është e domosdoshme të merren parasysh humbjet eksploatabile të cilat mund të arrihen deri në 5% . atëherë edhe prodhimi vjetor duhet të marrë parasysh dhe në këtë rast duhet planifikuar rritjen e prodhimit:

$$Q_{Vjet+EKSPL.Humb} = 100\,000 \cdot 100 / (100 - 5) = 105263 \text{ m}^3/\text{vit}.$$

$$Q_{HUMB\ EKSPL.} = 105263 - 100\,000 = 5263 \text{ m}^3/\text{vit}.$$

Për realizimin e prodhimit vjetor të gurit gelqeror duhet parapare edhe 5% material steril, në këtë rast koeficienti i shfrytëzimit merret (0,95), prandaj rezervat e shfrytëzueshme vjetore:

$$Q_{Eksplo} = 105263 \cdot 100 / (100 - 5) = 111000 \text{ m}^3/\text{vit}.$$

$$Q_{STER} = 111000 - 105263 = 5737 \text{ m}^3/\text{vit}.$$

Sipas vlerave të fituara mund të përcaktojmë përqindjen e humbjeve dhe asaj të shfrytëzimit të gelqerorve në shkallë vjetore:

$$Q_{vit} = 100000 / 111000 = 0.9 \text{ (90\% nga sasia e tersishme)}$$

$$Q_{HUMB.EKSP.} = 5263 / 105263 = 0.049 \text{ (4.9\% nga sasia e tersishme)}$$

$$Q_{STERIL} = 5737 / 111000 = 0.05 \text{ (5\% nga sasia e tersishme)}$$

Për realizimin e kësaj prodhimtarie të nevojshme duhet të plotësohen këto kushte teknike:

- numri i ditëve të punës (12X21) 252 dit
- numri i ndërrimeve

I,II,III,IV,IX,X,XI dhe XII muaji 1 ndërrim

V,VI,VII dhe VIII muaji 2 ndërrim

Gjithsejste $(8 \times 21) + (4 \times 1.5 \times 21)$ 294 ndërrime

Puna me ndërrime është e nevojshme të zbërthehet në kohën për punët ndihmëse dhe punët përgatitore. sipas treguesve real dhe praktikës së deri me tani në këtë 17

Projekti kryesor i shfrytëzimit shkëmbive gëlqerorë VB, „STANET” Zk.ASTRAZUP (Vazhdim i Licences Nr.1545)

gurore koha efektive për një ndërrim merret 7[h] ose koeficienti i shfrytëzimit kohore është

$$k_i = (8-1)/8 = 0.875$$

Tab.2.6 Kapacitetet prodhuese

Nr	Njësia kohore	Kapaciteti		
		[m ³] mk	[m ³] msh	[t]
1	Kapaciteti orarë	54	70.2	143
2	Dit me një ndërrim	378	491	1002
3	Dit me një ndërrim e gjysme	568	737	1500
4	8 muaj (168 dit 1 ndërrim)	63504	82555	168286
5	4 muaj (84 dit 1.5 ndërrim)	47594	61873	126125
6	Viti	111000	144300	294150

Me detyrë projektuese është paraparë që kapaciteti vjetor i guroses të jetë 100 000

[m³ /vit], fraksione të formacioneve gëlqerorë të separuar, së këndejmi afat shërbimi

i saj me ket anekse do të jet:

$$N = 1077397 / 110000$$

$$N \sim 10[\text{vite}]$$

d) Përlogaritja sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit

. Ndërtimi gjeologjik lokacionit

Ndërtimin gjeologjik të rajonit të gjerë e përbëjnë:

- sedimente e kuaternarit
- sedimentët e kretakut të sipërme.

Formacioni karbonatorë i kretakut të sipërm (K2) - Sedimentet e Kretës së lartë janë të zhvilluar në rajonin e Strazhëutnë formë të brezave të gjerë të produkteve flishor dhe zonave relativisht të mëdha të gelqerorve të përcaktuara nga serpentinitet.

Gelqeroret masiv paraqesin sedimentet bazike të shtresave flishore të kretës së lartë. Gelqeroret masiv të plasaritur ngjyrë hiri deri në hiri të mbyllt si dhe me nunca kah e bardha. Trashësia e tyre lëvizë nga 150-200m.

Kufijt me njësite tjera litostratigrafike janë kryesisht tektonik, shpesh të thyer në shkarje tërthore. Fauna në këtë shkëmbinjë është mirë e ruajtur. Veçohen gllobutrunkana dhe rudistet.

Sedimentet flishore ndertojnë horizontet më të larta të kompleksit të kretakut të lart. Seria e flishit karakterizohet me ndertim të tri katev litologjike: ranorve, mergeliteve dhe argjileve me varjatet e tyre. Në seri dallohen pjesët e poshtme ku dominon komponenti mergelor – argjilor dhe pjesët e sipërm kryesisht me komponentet ranore. Pjesët më të sipërm veçohen me ranor masiv.

Sedimentet e kuaternarit (Q) – Produktet kuaternare lajmërohen në formë të ë bartjeve aluviale. Përfaqësohen nga rëra, zhavorri dhe suargjila në pjesën veriore. Për efekt të veprimtarisë tektonike ky regjion është mjaftë kompleks dhe e cila ka ndikuar në copëzimin e masës së mermerizuar të paleozoikut dhe gëlqerorëve.

Ndërtimi gjeologjik është i thjeshtë. Me të përhapurit janë gëlqeroret masiv që në pjesën periferike të tyre ndodhen gëlqerorët mergelor flishor ndërsa në pjesën e poshtme të prrockës shtrihen sedimentet aluviale si dhe rreshpet.

Gëlqeroret masiv (K23) janë të zhvilluar në një hapësirë relativisht të gjerë 6-7km. Dhe gjerësi disa qindra metra. Trashësi e gëlqerorit nuk është e përcaktuar, ndërsa nga të dhënat e shuarjeve të afërta trashësia kalon 100m. Këta gëlqeror janë masiv pa shtresime të theksuara ngjyrë hiri të çelet deri në të hirit të mbyllët.

Vetit e blloqeve gëlqerore në kuadër të një zone mobile Gjeotektonike kanë bërë që ata gjatë evolucionit gjeodinamik të kores tokësore, në këto pjesë të pësoj deformime të shprehura në formë të qarjeve me gjenezë të ndryshme e cila mundë të shihet në strukturën mikroskopike të gëlqerorit.

Vendburimi ndërtohet nga këta anëtar litologjik:

- Seria gëlqerore
- Seria e serpentiniteve
- Argjila dhe prezenca rreshpeve.

Analizat kimike kanë treguar se përmbajtja e elementeve është në kondita të lejuara për shfrytëzim si që shihet më poshtë:

CaCO₃.....96.84% dhe

MgCO₃.....1.73%

Karakteristikat fiziko-mekanike të gëlqerorit te marruna nga gëlqerorët e vendburimit Kashani janë:

Pesha vëllimore2.69 g/cm³

Poroziteti.....3.82 %

Absorbimi.....0.22 %

Pozita gjeografike dhe topografike i objektit u përcaktua nga përshkrimet e më parshme.

Ndërtimi gjeologjik i vendburimit marrin pjesë gëlqeroret e triasikut të mesëm , të cilët alterohen me ndërfutje të thjerrëzave rreshpore .

Trashësia e pakos gëlqerore është më e madhe se sa thellësia maksimale e objektit për të cilën llogariten rezervat . Elementet si shtrirja ,rënja e gëlqerorit janë të rregullta pa ndërfutje tektonike.

Shkëmbinjte karbonatike janë grupi më i përhapur i shkëmbinjve sedimentar ku bëjnë pjesë gëlqeroret me këtë përbërje kimike:

Ca –54.7-56%

CaCO₃-0.0-2.3%

MgO- 0.0-2.3%

Vendburimi në Korroticë të Epërme në aspektin gjeologjik është i përbërë nga:

- Gëlqeroret e triasikut (T23)
- Gëlqeroret e mermeritizuar,
- Argjila e kuqe
- Mbules diluviale.

Ne ndërtimin e vendburimit dominojnë gëlqerorët e triasikut që kanë shtrirje dhe pjesëmarrje me te madhe. Gëlqeroret shtresore me drejtim të shtrirjes me azimuth VP-JL.

450 -250

Vendburimi i gurit gëlqeror në objektin e kërkuar bënë pjesë në strukturën antiklinale. Ky vendburim nderohet nga gëlqeroret e triasikut së sipërm që kanë dalje në sipërfaqe .

Gëlqerorët e këtij vendburimi i përkasin tipit kalimtar. Këta shkëmbinj të emërtohen në bazë të llojit të kokrrizave .Zakonisht lënda lidhëse është kalçiti shpatik.

Këto depozitime janë kryesisht gëlqeror me një shkallë të mermeritizimit. Në vendburim i takojmë gëlqerorët me ngjyrë të bardhë me nuance bezhe.

Kufiri gjeologjik është brenda parcelës së lejuar për eksploitim. Nga këto të dhëna dallojmë gëlqeror ngjyrë të kuqërremet dhe gëlqeroret gri ngjyrë të bardh.

Gëlqeroret ngjyrë të kuqërremët . Struktura e këtyre gëlqerorëve është e shprehur me prezencë të qarjeve .Predominon ngjyra gri e mbyllët , janë kompakt dhe brenda tyre dallohen damarë të holla kalçiti me trashësi disa cm.

Në pakon e vendburimit takojmë shtresa gëlqerore me ngjyrë bezhe në të kuqërremt që trashësia sillet deri në 15cm. Kjo shtresë është e lidhur dobët me procesin e dollimitizimit të gëlqerove. Ngjyra e kuqe rrjedh nga prezenca e getitit.

Gëlqeroret Bllokor me ngjyrë gri të bardh. Këta gëlqeror janë shtresor me prezencë të madhe të mikroqarjeve . Ky lloj i gëlqerorit përfaqëson pjesën më të madhe të trupit mineral. Ngjyra e shkëmbinjve është gri e bardhë dhe vende me nuance bezhe.

Nderimi struktural i trupi është i ndërthurur me gëlqeror shtresor dhe blloqe me prezent të qarjeve që në sipërfaqe janë të mbushura me produkte të kuaternarit .

Prezenca e qarjeve në gëlqeror e bënë që në trashësinë deri 0.5m në sipërfaqe të ketë koncentrim të masave argjilor , që kjo në fazën fillestare dotë ja ulë pastërtinë e gurit gëlqeror gjegjësisht rritë masën sterile që duhet të ndahet gjatë procesit të seperimit të gurit gëlqeror. Masa e sterile sillet deri në masën 13.5% nga masa e përgjithshme e rezervave gjeologjike

Përbërja e gëlqerorit të pastër 56% CaO dhe 44% humbje në kalcium

Procesi teknologjik i shfrytëzimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror

Përshkrimi i teknologjisë të shfrytëzimit të gurit gëlqeror

Për të shfrytëzuar gurin gëlqeror duhet të kryhen këto procese teknologjike: duhet bërë largimin e shtresës së dheut (sterilit), shpim, minim, ngarkim dhe transport . Për realizimin e procesit teknologjik për shfrytëzimin e gurit gëlqeror nevojiten këto pajime: Garnitura për shpim, një ekskavator, një bulduzher, një lopatë ngarkuese dhe dy deri tre kamionë special për bartjen e shkëmbit të minuar gjerë te gurthyesi me seperacion.

Punimet e shfrytëzimit të gëlqerorëve në këtë vendburim do të zhvillohen sipas projektit kryesor të Xehetarisë ku janë përcaktuar të gjithë parametrat tekniko-teknologjik për shfrytëzim.

Në bazë të përvojës gjatë punës në kushte të njëjta dhe duke marrë për bazë karakteristikat e shkëmbinjve gëlqerorë në vendburim janë përcaktuar parametrat kryesor për hapje të karrierës:

- lartësia e shkallëve do të jetë 10m.
- gjerësia e sheshit të shkallës është 10-15m.
- pjerrtësia punuese e shkallës është 70 gradë.
- Shfrytëzimi i gurit gëlqeror do të kryhet përmes 3 shkallëve.
- sterili dhe materiali humosor nëpër rrugë të projektuara do të bartet dhe deponohet në deponin e caktuar për të dhe pastaj do të deponohet në sipërfaqen e shfrytëzuar.
- karakteristikat hidrogjeologjike janë të volitshme nga aspekti i shfrytëzimit sepse ujërat atmosferik me punime minerare lehtë largohen nga karriera

- hapja e karrierës bëhet duke u nisur nga kuota fillestare e vendburimit nga lartësia në nivelin e kuotës 698m dhe nga thellësia në nivelin e kuotës të shkallës 668m, me disnivel prej 30m.

Ky proces bëhet në faza të cilat u cekën më lartë .

Etazhet zhvillohen në drejtim veri- jug, dhe atë në një kat bëhet shpimi dhe përgatitja e fushës për minim , kurse në katin (etazhin) më lart bëhet ngarkimi dhe transporti i masës së minuar më herët .

Minimi bëhet me eksplozive Amonali i përforcuar i cili është treguar efektiv në shfrytëzimin e gurit gëlqerorë.

Për të pas një pasqyrë reale të lëndëve plasëse në këtë raport të VNM-s do ti japim karakteristikat teknike të Amonalit të përforcuar.

Tipi i lëndes plasëse

1. Amonium nitrat.....-82+1.5%
2. Trinitro trotuol.....- 14 + 1%
3. Tallash druri.....- 4 + 0.5%

Karakteristikat

Dendësia	kg/l	1.1-1.15
Shpejtësia e detonimit	m/s	4400-4500
Përcjellja e detonimit	cm	4-9
Bilanci i oksigjenit	% peshore	4
Vëllimi i gazrave	L/kg	+0.24
Lirimi i nxehtësisë	⁰ C	2564
Presioni i deponimit	Dn/m ²	56619
Diametri i llokumit	Ø	60

Në rastin e minimit në gurin gëlqeror, është e kalkuluar largësia e gjuajtjes së copave shkëmbore, gjë që nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrethinën. Konsumi specifik për një vrimë është llogaritur të jetë 30 kg e cila është 36 herë më e vogël se sasia e lejuar për shkallen e tretë të merkalit ku shpejtësia e lejuar e oscilimeve të trupit është 0.4 deri në 0.8 cm/s.

Por tani me sistemin e ri të minimit, do të kemi sigurinë ma të madhe.

Nga kjo mundë të konstatojmë që veprimet sezmiologjike në objektet sipërfaqësore duke marrë parasysh distancën e larguar është i pranueshëm në procesin teknologjik.Rrezja e zonës së rrezikut caktohet në bazë të përdorimit të eksplozivit që aktivizohet:

$$R = 5 \sqrt[5]{Q} = 5 \sqrt[5]{2478} = 248,89 \approx 250 \text{ m'}$$

R- zona jo e rrezikuar për njerëz dhe objekte nga copat e hedhura të shkëmbit

Q- sasia e eksplozivit për një minim

5- koeficient i cili merret për distancën e palosjes së masës së shkëmbit (m)

Prandaj minimet në këtë lokalitet nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrethinën sepse objektet banuese janë të larguara nga lokacioni mbi 500m, kurse zona e rrezikuar për njerëz dhe objekte nga copat e hedhura të shkëmbit është $\approx 250\text{m}$.

Nga minimi gjithmonë duhet të ketë kujdes që madhësia e shkëmbit të minuar të jetë në granullometri të lejuar për fytyrën e thërmueseve primare, gabaritet e mëdhenj nuk guxojnë të jenë prezent më tepër se 20% nga madhësia e fytyrës.

Përshkrimi i thërmueses me seperacion dhe pajimeve përcjellëse

Pronarët e Kompanisë „Durimi ” për realizimin e procesit teknologjik për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror planifikojnë të blejnë pajimet të prodhuara nga kompania Ugur Makina nga Turqia të prodhuara në vitin 2017, të cilat do të i vendos në pjesën e ngastrës të lartshënuar:

Thërmuesja me nofulla kapaciteti $80\text{-}100\text{m}^3/\text{h}$, thërmuesja me nofulla, ka të bashkangjitur bunkerin pranues me vëllim prej 15m^3 , dozatorin me vibrim dhe transportuesit shiritor për bartje të materialit steril dhe atij të thërmuar. Pronari i kompanisë planifikon të e blejë seperacionin (sitën vibruese të pjerrtë) dimensionet e sitës do të jenë $1530 \times 4800\text{mm}$, kapaciteti i sitjes gjërbërës $100 \text{ m}^3/\text{h}$, seperacioni (sita vibruese e pjerrtë) do të jetë, sitë një etazhore me mundësi për vendosjen edhe të dy rrjetave, transportuesit shiritor për transportimin materialit të seperuar, edhe një gurthyes sekondar (mullirin) me traj dhe një sitë vibruese me shirita transportues, para gurthyesit sekondar (mullirit) me traj do të ekzistoj shiriti transportues për sjelljen e fraksionit + 22 apo 32mm, pas gurthyesit sekondar (mullirit) me traj do të ekzistoj një shirit transportues për bartjen e materialit të thërmuar në sitën vibruese, pastaj do të ekzistojnë edhe katër shirita transportues përmes të cilave materiali i seperuar transportohet në deponit adekuate, dhe një shirit transportues për kthimin e mbifraksionit +32 mm në gurthyes terciar (mullirit) me traj për tu rithërmuar e pastaj përmes shiritit transportues materiali i thërmuar hedhet në shiritin transportues i cili e bartë materialin e thërmuar nga thërmuesja sekondare në sitën vibruese. Me këto pajime ekzistuese mund të prodhohen fraksionet si që janë +0-2 mm, +2-4 mm, +4-8 mm, +8-16 mm, +16-22 mm +16-32 mm dhe +32mm, për tampon për agregat betoni, agregat asfalti dhe elemente të betonit (kubzat dhe gypat e betonit), etj.

Procesi teknologjik i gurëthyesit me seperacion

Prodhimi në gurëthyes me seperacion bëhet në bazë të kërkesave për fraksione të blerësve, në bazë të cilave bëhet edhe plani i biznesit të Kompanisë. Prodhimi në gurëthyes me seperacion bazohet në prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, e fraksioneve për agregat betoni, agregat asfalti dhe elementeve të betonit (kubëzat dhe gypat e betonit). Në vijim po japim përshkrimin e procesit teknologjik komplet të gurthyesit me seperacion për prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, për agregat betoni, agregat asfalti dhe elementeve të betonit (kubzat dhe gypat e betonit).

Guri gëlqeror nga kamionët derdhet në bunkerin pranues të gurëthyesit ose nga deponia me anë të lopatës ngarkuese derdhet në bunkerin (furtinën) pranuese shënuar me nr. 1, të gurëthyesit të cilin në kemi dhënë në vizatim (shema teknologjike), mandej me anë të dhënësit vibruës nr. 2, ushqehet thërrmuesja primare me nofulla nr. 3, transportuesi shiritor nr. 2a është i dedikuar të bart materialin steril që ndahet nga guri gëlqeror përmes vrimave që janë të vendosura në dhënësin vibruës, në këtë mënyrë bënë pastrimin e gurit gëlqeror që do të trajtohet në gurëthyesin me seperacion dhe të përgatis prodhimin për aplikim sa më mirë në ndërtimtari të ulët dhe të lart, nga thërrmuesja primare me nofulla nr. 3, guri gëlqeror me transportues shiritor nr. 4, transportohet në siten vibruëse nr. 5 , nga ku fraksioni 0-32mm përmes transportierit shiritor nr.6 dërgohet në deponin adekuate, kurse fraksioni + 32mm përmes transportierit shiritor nr.7 dërgohet në thërrmuesen sekondare me traj (mullirin) nr. 8, materiali i thërrmuar përmes transportierit shiritor nr.9 dërgohet në sitën vibruëse nr.10, nga sita vibruëse përmes shiritave transportues nr. 11, nr. 12, nr. 13, dhe nr. 14, transportohen fraksionet e prodhuara +0-4 mm, +4-8 mm, +8-16 mm, +16-22 (32) mm në deponit adekuate për këto fraksione, kurse përmes shiritit transportues nr. 9a, fraksioni mbi 22 (32)mm kthehet në thërrmuesen terciare me traj (mullirin) nr. 8a, për tu thërrmuar prapë, materiali i thërrmuar përmes shiritit transportues nr. 9b dërgohet në shiritin transportues nr. 9 përmes të cilit dërgohet në sitën vibruëse nr.10. Në sitë sigurisht se mbetet një sasi e cila kalon kufijtë e të kërkuarës (do më than se madhësia e një pjese të kokrrave të fraksionit është më e madhe se vrimat e sitës), prandaj këjo sasi e materialit do të kthehet përsëri me anë të transportuesit shiritor nr 9a, në thërrmuesen terciare numër 8a, ku do të thërrmohet në madhësi të fraksioneve të lejuara, dhe kështu e përgatitur sëbashku me materialin tjetër me transportier shiritor nr. 9b dhe 9, kthehet në sitën vibruëse nr. 10, për trajtim të dytë, e po që se ka nevojë (ajo në mënyrë kontinuale) do të kthehet edhe herave tjera në thërrmuesen terciare gjërë sa të fitohet madhësia e fraksioneve që do të kalojnë nëpër rrjeta të sitës.

Menaxhimi i procesit teknologjik bëhet nga dhoma e cila duhet ndërtuar afër gurthyesit e në të cilën do të vendosen ormani me tërë automatiken dhe mbrojtësit për tërë hargjuesit e energjisë elektrike, si dhe pulti komandues i cili është i vendosur në ormanin adekuat të caktuar për te.

Automatika do të rregullohet në atë mënyrë që mundëson lëshuarjen në punë të pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike dhe manuale. Në pultin komandues do të ekzistojnë rregullatori komandues për zgjedhjen e punës së gurthyesit me seperacion.

Nëse zgjedhim punën automatike, atëherë për fillimin e startimit të pajimeve të gurthyesit me seperacion, pajimet lëshohen në punë automatikisht, duke filluar nga më të largëtat kah të afërmet, nga transportierët për fraksion finale, pasandaj sita vibruese, transportieri shiritor, gurthyesin sekondar dhe sekondar, transportierët shiritor tjerë, sita vibruese, transportierët shiritor, thërrmuesen primare me nofulla, transportieri shiritor dhe në fund dozuesin vibrues.

Te ndalesa e pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike, pajimet ndalen me radhë në anën e kundërt të lëshimit të pajimeve duke filluar nga dozuesi vibrues e tutje.

Të zgjedhja e punës në mënyrë manuale, pajimet lëshohen në punë secila në vete, përmes tastereve të veçanta, sipas zgjedhjes ton, gjithashtu edhe te komanda manuele duhet respektuar radhën, e lëshimit të pajimeve në punë, sikurse të mënyra automatike. Udhëheqja manuele preferohet vetëm në raste të defekteve, dhe në raste të remontit të pajimeve.

Në këtë mënyrë, me anë të këtyre proceseve teknologjike në gurëthyesin me seperacion mund të prodhojmë këto fraksione nga guri gëlqeror: fraksione për tampon të rrugëve, fraksione për beton dhe fraksione për prodhim të asfaltit të cilat do të i paraqesim më poshtë.


Fraksionet e tamponit të rrugëve 0 - 32 mm, 0 - 63 mm dhe 0 - 100mm

Fraksione e Betonit 0 - 4 mm, 4 - 8 mm, 8 - 16 mm, 16 – 22 ose 32 mm

Fraksionet e asfaltit 0-2 mm, 2- 5 mm, 5-8 mm, 8 - 11 mm, 11 - 16 mm, 16-22 mm

Pajimet në gurëthyes me seperacion aktivizohen me anë të energjisë elektrike ku pronari do të bëjë ndërtimin e trafos dhe të rrjetit elektrik me mjete personale. Por për shkak të ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike investitori do të pajiset edhe me një gjenerator për aktivizimin e pajimeve teknologjike, gjithashtu në këte lokacion pronari planifikon të e ndërtoj oficinën për mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese si dhe pajimeve prodhuese. Përveç pajimeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin gurit gëlqeror dhe shërbimeve tjera kompania do të disponoj mekanizëm ngarkues dhe transportues si.psh. dy lopata ngarkuese, një ekskavator, gjashtë kamionë etj. Ndërtesën për personelin e kompanisë dhe mbajtjen e pjesëve rezervë

Renditja dhe lidhshmëria e pajimeve dhe stabilimenteve në mes veti të cilat nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror të cilat do të blihen dhe vendosen në pjesën e ngastrës së lartë cekur shihet në shemën teknologjike në vijim.



Legjenda

- 1, bunkeni pranues, 2a, shiriti transportues, 2. dozuesi vibrues, 3, gurthyesi me nofulla 4, shiriti transportues, 5. sita vibnuese, 6,7. shiritat transportues,
- 8, 8a. gurthyesi me traj 9,9a, 9b, shiritat transportues, 10. sita vibnuese, 11,12,13,14. shiritat transportues,

3.5. Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Zbatimi dhe operimi i impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror kërkon shfrytëzimin e burimeve të ndryshme materiale, energjetike dhe njerëzore, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e qëndrueshëm dhe efikas të procesit e shfrytëzimit dhe teknologjik. Lloji dhe sasia e këtyre burimeve janë përcaktuar në përputhje me kapacitetin e planifikuar të impiantit dhe karakteristikat teknike të pajisjeve të instaluara. Burimi kryesor material është lënda e parë, respektivisht guri gëlqeror i papërpunuar, i cili me pas përpunohet në impiant për prodhimin e fraksioneve të ndryshme të aggregateve. Sasia e lëndës së parë varet nga kapaciteti i prodhimit dhe planifikimi operativ i impiantit, dhe është në përputhje me kërkesat e tregut dhe kushtet teknike të funksionimit. Energjia elektrike përbën burimin kryesor energjetik dhe përdoret për funksionimin e thërrmuesve, sitave vibruese, transportuesve me rripa, sistemeve të automatizimit dhe pajisjeve ndihmëse. Konsumi i energjisë elektrike është i lidhur drejtpërdrejt me intensitetin e prodhi mit dhe orarin e operimit të impiantit. Kompania ka planifikuar ndërtimin e trafos per furnizim me energji. Uji përdoret kryesisht për kontrollin e pluhurit në pikat kritike të procesit teknologjik, si dhe për nevoja sanitare dhe mirëmbajtje të pajisjeve. Konsumi i ujit është relativisht i kufizuar dhe nuk përfshin përdorim të ujit në procesin teknologjik të përpunimit. Furnizimin me uje kompania ka parapare përmes cisternave. Një burim i rëndësishëm janë edhe burimet njerëzore, që përfshijnë personelin për operimin e impiantit, mirëmbajtjen teknike, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e procesit. Numri i punonjësve përshtatet me kapacitetin e impiantit dhe per fillim do te jete 20 punetore. Të gjitha burimet e nevojshme shfrytëzohen në mënyrë të kontrolluar dhe racionale, duke respektuar kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në punë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

3.6. Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Gjatë zbatimit dhe funksionimit të impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror gjenerohen lloje të ndryshme mbeturinash dhe emisionesh, të cilat lidhen drejtpërdrejt me natyrën mekanike të procesit teknologjik. Ky vlerësim është bërë duke marrë parasysh kapacitetin e planifikuar të impiantit, pajisjet e instaluara dhe mënyrën e operimit të procesit. Mbeturinat kryesore që krijohen gjatë shfrytëzimit dhe procesit teknologjik janë të natyrës inerte. Ato përfshijnë fraksione shumë minerare, materiale që nuk përmbushin kërkesat granulometrike të tregut, si dhe mbetje nga pastrimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Këto mbeturina konsiderohen mbeturin a jo të rrezikshme dhe, në pjesën më të madhe, rikthehen në proces për ripërpunim apo shfrytëzohen për qëllime teknike, si

stabilizim i sipërfaqeve brenda impiantit. Gjatë operimit gjenerohen gjithashtu mbeturina komunale, të cilat burojnë nga aktivitetet e përditshme të personelit, si ambalazhe ushqimore dhe materiale të tjera të ngjashme. Sasia e tyre është e vogël dhe menaxhohet përmes grumbullimit të veçantë dhe konsiderohen si mbeturinave komunale, ku operatorët ekonomik janë të obliguar të bëjnë kontrat me Kompanit e pestrimit. Emetimet kryesore të lidhura me procesin teknologjik janë emetimet e pluhurit, të cilat krijohen gjatë fazave të thërrmimit, sitjes dhe transportit të materialit. Sasia e pluhurit varet nga karakteristikat fizike të gurit, intensiteti i operimit dhe kushtet atmosferike. Për reduktimin e këtyre emetimeve janë parashikuar masa teknike, si sistemet e spërkatjes me ujë në pikat kritike të procesit, mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe kontrolli i rrjedhës së materialit. Zhurma përbën një tjetër ndikim mjedisor, e cila buron nga funksionimi i thërrmuesve, sitave vibruese, transportuesve dhe mjeteve ndihmëse. Nivelet e zhurmës janë të përqendruara kryesisht brenda kufijve të impiantit dhe menaxhohen përmes përdorimit të paj isjeve moderne, mirëmbajtjes teknike dhe organizimit të orarit të punës në përputhje me kërkesat ligjore. Procesi teknologjik nuk përfshin procese djegieje dhe nuk krijon emetim të gazeve ndotëse nga burime stacionare industriale. Po ashtu, impianti nuk prodhon ujëra të ndotura teknologjike, pasi uji përdoret vetëm për kontrollin e pluhurit dhe për nevoja ndih mëse, pa u shkarkuar si ujë i ndotur nga procesi.

3.1. Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit nuk përdoret asnjë pajisje për trajtimin e mbeturinave, pasi procesi i shfrytëzimi të gurit gëlqeror dhe ai teknologjik nuk krijon mbeturina që kërkojnë trajtim në lokacion. Mbeturinat komunale që krijohen nga aktivitetet e personelit grumbullohen veçmas dhe merren nga kompania e kontraktuar për grumbullimin e mbeturinave nga Komuna .

3.8. Programi kohor i ndërtimit dhe operimit të projektit dhe faza e rehabilitimit pas përfundimit të funksionimit

Zbatimi i projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzim, përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror është planifikuar të realizohet në disa faza të ndara kohore, me qëllim të sigurimit të një zhvillimi të kontrolluar dhe funksionimi të qëndrueshëm të impiantit. Faza e ndërtimit përfshin punimet përgatitore të terrenit, ndërtimin e infrastrukturës së brendshme, instalimin e pajisjeve teknologjike dhe lidhjen me rrjetet

përkatëse. Kjo fazë parashihet të zgjasë rreth 5 – 7 muaj, në varësi të kushteve teknike dhe organizative. Faza e operimit fillon pas përfundimit të ndërtimit dhe testimit të pajisjeve. Impianti është planifikuar të funksionojë për një periudhë afatgjatë, në përputhje me lejet dhe autorizimet përkatëse, pa kufizim të paracaktuar kohor, për aq kohë sa plotësohen kushtet ligjore dhe teknike për operim. Në rast të përfundimit të funksionimit të projektit, parashihet ndërprerja graduale e aktivitetit dhe çmontimi i pajisjeve teknologjike. Sipërfaqet e shfrytëzuara do të pastrohen dhe, sipas nevojës, do të kryhen masa rehabilituese, përfshirë nivelimin e te rrenit dhe rikthimin e tij në një gjendje të qëndrueshme dhe të sigurt nga aspekti mjedisor.

Struktura përfundimtare e sipërfaqes për rikultivim është e paraqitur në planin dhe projektin e rikultivimit. Pas përfundimit të punimeve minerare me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera . Propozohet që rikultivimi të bahet me pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe të pyllëzuara me bimë halore në ngastrën ku bëhet eksploatimi i gëlqerorëve.

Për të qen rikultivimi sa më i suksesshëm duhet të kryhen këto faza të procesit të rikultivimit: Rikultivimi teknik, Rikultivimi agroteknik dhe Rikultivimi biologjik.

Rikultivimi teknik

Në bazë të ligjeve relevante të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve minerare, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të karrierës, investitori është i obliguar që tokës ti kthej pamjen e më parëshme. Në bazë të punimeve të kryera hartografike-pedologjike në mihjen sipërfaqësore duhet konstatuar se cilët pjesë iu është nënshtuar dëmtimeve nga veprimet minerare, për këtë arsye duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intezitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimore e pastaj të shqyrtohen mundësit e sanimit të efekteve të pavolitshme si dhe rikultivimi i kësaj pjese. Gjatë rikultivimit teknik duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi të kryhet njëkohësisht gjatë punimeve në minierë, pra me teknologjinë mih – transporto – palos.

Me krijimin e sipërfaqes së lirë nga sheshet punuese duhet të fillohet me dizajnimin teknik të hapësirës së lirë duke bërë përgatitjen e terrenit për rikultivim. Pas përfundimit të aktiviteteve minerare hapësira do të merr formën e degraduar e ndryshuar me peizazhin ekzistues, e cila me rastin e rikultivimit zonës i jep një pamje natyrale.

Pas përfundimit të punimeve minerare fillon rikultivimi teknik i sipërfaqeve tokësore të degraduara. Degradimi i tokës gjatë punimeve minerare shkon deri në at masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj për këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara.

Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet mihja selektive e humusit dhe vendosja direkte në sipërfaqet punuese ku janë kryer punimet, d.m.th. duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi teknik të kryhet njëkohësisht gjatë zhvillimit të punimeve në minierë. Pra me përfundimin e shfrytëzimit të vendburimit nga punimet e para minerare të lira, fillon shtresimi i dheut dhe humusit në këto shkallë. Nëse konstatojmë se shterpa nuk i plotëson kërkesat kualitative për rikultivim kem cek edhe më parë, duhet të konsultohen ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe të sillet sasia e dheut nga një vend tjetër me qëllim të suksesit të rikultivimit.

Rikultivimi agroteknik

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re.

Eksplotimi i gëlqerorit me teknologjinë minerare dëmton mjedisin jetësor. Toka është njeri prej elementeve të këtij mjedisi të cilës përveç që i ndërrohet destinimi primar, pëson degradim të rënd, deri në zhdukjen fizike të profilit pedologjik të sajë. Kjo paraqet formën më të rënd të dëmtimit të tokave. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një masiv të fort e cila është e mbuluar me tokë të cektë.

Për të llogaritur numrin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend.

$$Nf = S / a \times b$$

S - paraqet sipërfaqen, a – paraqet distancën në mes rendeve b – paraqet distancën në mes fidaneve. Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distance të jenë nga 2 m.

Në pjesët ku do të behët mbjellja e bimëve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij

substrati me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar.

Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që rrënjës t'i siguroj shtrirje sa më të lirë. Nëpër këto gropa duhet të hedhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të shtallës e pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë.

Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidaneve. Fidanët duhet të shoqërohen me ambullazh përkatëse ne momentin e blerjes. Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara. Para se të mbillen fidanët, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajage të freskët dhe argjile me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje. Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta. Gjatë dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasitë optimale të lagështisë, kështu ne pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj.


Pas mbjelljes së silvokulturave, pronari më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre .

Rikultivimi biologjik

Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijohet ekosistem të ri në hapësirat e shfrytëzuara dhe të dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësore, blegtorale dhe në silvikulturë.

Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Bimët të cilën e kemi propozuar në këtë projekt në sipërfaqet e mihjes sipërfaqësore është Pisha e zezë - *Pinus tigris* L. dhe Pisha e bardhë- *Pinus silvestris* L. Me kurorën e tyre pisha e zezë dhe e bardhë , i japin pamje të bukur peizazhit, janë bimë që i përgjigjen lartësisë mbidetare të cekura ne pasuset e më sipërme , si dhe janë bimë lehtë adaptuese dhe rezistuese ndaj dëmtuesve biologjik. Edhe pse janë propozuar kto bimë , duhet të bëhet konsultimi me autoritetin e Ministrisë së bujqësisë dhe pylltarisë.

Përgatitja dhe mbjellja e fidaneve shihet ne figurat e më poshtme.



3.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror kërkohet infrastrukturë bazë teknike dhe funksionale, e cila siguron funksionim të rregullt dhe të sigurt të projektit. Lokacioni i projektit ka qasje në infrastrukturën ekzistuese rrugore, e cila mundëson hyrje dhe dalje të mjeteve transportuese për furnizimin me lëndë të parë dhe shpërndarjen e produkteve të përpunuara. Brenda lokacionit investitori ka paraparë ndërtimin e rrugëve të brendshme për qarkullimin e mjeteve dhe makinerive, si dhe hapësirave për manovrim dhe parkim. Furnizimi me energji elektrike do të

siguroj, nga trafo e cila do te ndërtohet brenda impiantit, me instalim të pajisjeve mbrojtëse dhe sistemit të kontrollit elektrik për funksionimin e impiantit. Uji i nevojshëm për kontrollin e pluhurit dhe nevoja ndihmëse sigurohet përmes cisternave, pa lidhje me rrjetin publik të ujësjellësit dhe pa shkarkim të ujërave të ndotura teknologjike.

3.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Për zbatimin e projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror nuk parashihet ndërtimi i kampeve apo rezidencave për punëtorë . Personeli i angazhuar do të sigurohet nga zona përreth dhe nuk ka nevojë për akomodim të përhershëm brenda lokacionit të projektit. Aktivitetet ndihmëse kufizohen në përdorimin e hapësirave funksionale minimale, si zyra administrative dhe ambiente për personelin, të cilat do të vendosen brenda lokacionit dhe nuk do të kenë ndikim të konsiderueshëm në mjedis.

3.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Për realizimin e projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror, investitori është i obliguar të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Lejet dhe licencat kryesore që kërkohen për zbatimin e projektit përfshijnë:

1. Pelqimi komunal, ne komunne ku do te realizohet projekti.
2. Vleresimi I ndikimi ne mjedis (VNM), e cila merret ne MMPHI.
3. Pëlqimin për ndërtimin e trafostacionit dhe lidhjen me rrjetin energjetik, nga operatori përkatës i energjisë elektrike , KEDS ;
4. Licenca nga KPMM .
5. Leja Mjedisore, MMPHI.

3.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Ky Projekti për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror realizohet në mënyrë tërësisht autonome dhe nuk paraqet ndërlidhje teknologjike apo funksionale me projekte të tjera ekzistuese. Funksionimi i impiantit është i pavarur dhe realizohet në mënyrë tërësisht autonome. Po ashtu, projekti nuk varet nga sisteme të përbashkëta të furnizimit me ujë apo infrastruktura të tjera teknike.

Ndërlidhja e vetme me projektet ekzistuese në zonë kufizohet në përdorimin e infrastrukturës së jashtme rrugore publike, e cila është e zhvilluar dhe e mjaftueshme për nevojat e projektit.





Figura 3. Distanca me biznese tjera është e madhe (mbi 300 m)

4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

4.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Lokaliteti ku planifikohet të kryhet eksplatinimi termimi dhe seperimi i gurit gëlqeror ndodhet ne vendin e quajtur Ushi në lindje të fshatit Strazhë, në anën e majtë të rrugës kryesore Prishtinë-Gjilan(3500m larg nga magjistralja), pronë Shoqërore Drushtvena svojina ,zona kadastrale e fshatit Strazhë Komuna Novo Berdë **Qertifikata nr.00673-1dhe 00673-2 ngastrat P-72403058-00673-1 dhe P-72403058-00673-2, numri i certifikates 128/2024 dt 05.02.2024 me sip S=50546m² me kulturë kullosë klasa 6 dhe mal kl 4**






VB “ STRAZHË KK NOVO BERDË

Kopanija ka pëlqimin komunal dhe nga Agjensioni pyjor i Kosovës për ushtrimin e veprimaris. VB ndodhet ne një lokacion i cili është mbi 2000 m largë nga objektet e banimimt – vendbanimi të fshatit Strazhë.

Ky Vendburimi i gëlqerorit shtrihet në koordinatat dhe koordinatat per qasje ne rrugë

Koordinatat e Licences		
Nr.	Y	X
1	7533953.39	4710530.088
2	7534126.022	4710582.89
3	7533998.803	4710749.433
4	7533906.854	4710909.614
5	7533818.544	4710894.133
6	7533881.948	4710701.797
S= 5ha 00m2		

Koordinatat e qasjes në rrugë		
Nr.	Y	X
15	7533868.9	4710902.953
16	7533864.8	4710902.246
17	7533813.6	4711027.379
18	7533816.7	4711030.383
S= 5ARI 46m2		



Ne aspektin morfologjik, regjioni përbëhet nga pjesë me relief të lartë mbi 900m si varg malet e Grykes se Strazhes. Relievi në përgjithësi është më tepër kodrinor-malore dhe i përcillur me shumë pak sipërfaqe të rrafshëta dhe me tokë bujqësore. Këtu popullata më tepër merret me bujqësi kurse një pjesë e popullatës merret edhe me blegtori. Lidhjet me komunikacionin rrugor janë mjaftë të mira ,vendburimi lidhet me rrugën e asfaltuar Novo Berdë-Strazhë dhe pastaj me të gjitha pjesët e Kosovës.

4.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Ky Vendburimi i gëlqerorit shtrihet në koordinatat dhe koordinatat per qasje ne rrugë

Koordinatat e Licences		
Nr.	Y	X
1	7533953.39	4710530.088
2	7534126.022	4710582.89
3	7533998.803	4710749.433
4	7533906.854	4710909.614
5	7533818.544	4710894.133
6	7533881.948	4710701.797
S= 5ha 00m²		

Koordinatat e qasjes në rrugë		
Nr.	Y	X
15	7533868.9	4710902.953
16	7533864.8	4710902.246
17	7533813.6	4711027.379
18	7533816.7	4711030.383
S= 5ARI 46m²		

Ne aspektin morfologjik, regjioni përbëhet nga pjesë me relief të lartë mbi 900m si varg malet e Grykes se Strazhes. Relievi në përgjithësi është më tepër kodrinor-malore dhe i përcillur me shumë pak sipërfaqe të rrafshëta dhe me tokë bujqësore. Këtu popullata më tepër merret me bujqësi kurse një pjesë e popullatës merret edhe me blegtori. Lidhjet me komunikacionin rrugor janë mjaftë të mira ,vendburimi lidhet me rrugën e asfaltuar Novo Berdë-Strazhë dhe pastaj me të gjitha pjesët e Kosovës.




Figura 4. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit që do të ndërtohet në territorin e Komunës së Novo Berdës

Në skicat përkatëse është paraqitur gjithashtu lidhja rrugore e lokacionit të projektit me qytetin e Novo Berdës dhe zonat përreth, përmes rrjetit ekzistues rrugor. Kjo lidhje siguron qasje funksionale për fazën e ndërtimit dhe për aktivitetet e mirëmbajtjes gjatë operimit, pa pasur nevojë për ndërhyrje të mëdha infrastrukturore.





Figura 5. Distanca e kompanisë me qytetin e Novo Berdës






Figura 6. Plan situacioni i shtrirje s së Impiantit .

Skica dhe planimetria e paraqitur konfirmojnë se projekti është i shpërndarë në disa parcela të ndara, të cilat së bashku përbëjnë një tërësi funksionale për realizimin e kapacitetit të planifikuar.

4.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti

Distanca ndërmjet lokacionit të propozuar për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e shkëmbinjve të fort dhe qendrave të banuara përreth është vlerësuar në bazë të matjeve hapësinore të paraqitura në planimetrinë përkatëse. Analiza e distancave është realizuar duke marrë si pikë reference kufirin e parcelës ku është planifikuar ndërtimi i impiantit dhe objektet më të afërta të banimit në fshatin Seçishtë, Komuna e Novo Berdës. Bazuar në të dhënat e matjes së paraqitura në planimetri, rezulton se:

- distanca minimale ndërmjet lokacionit të projektit dhe qendrës më të afërt të banuar është rreth 905 m,

Këto distanca konsiderohen të përshtatshme për këtë lloj veprimtarie industriale, duke marrë parasysh karakterin e zonës, konfigurimin e terrenit dhe faktin se impianti është i vendosur jashtë zonës së drejtpërdrejtë të vendbanimeve. Po ashtu, distancat ekzistuese krijojnë hapësirë të mjaftueshme për zbatimin e masave teknike dhe organizative për kontrollin e zhurmës, pluhurit dhe vibrimeve gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit. Pozicionimi hapësinor

i projektit, në raport me qendrat e banuara përreth, nuk pritet të shkaktojë ndikime të konsiderueshme negative në popullatë, me kusht që të zbatohen masat e parapara të mbrojtjes mjedisore.



Figura 7. Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi

4.4. Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Pedologjike - Territori ku planifikohet ndërtimi i impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e shkëmbinjve të fort është kryesisht i mbuluar me tokë natyrale me mbulesë bimore të shpërndarë.

MORFOLOGJIA E TERENIT

Morfologjia e regjionit që e përkufizon këtë VB. karakterizohet me një relief kodrinor malor, lokacioni në të cilin gjendet gurorja i takon pjesës së ngritur të masivit të gëlqerorëve të kësaj zone dhe shtrihet në mes të lartësisë mbidetare 735 deri 680. Konditat klimatike që mbretërojnë në këtë regjion janë relativisht të mira në krahasim me regjionet tjera.

NDËRTIMI GJEOLGJIK I VENDBURIMIT

Ndërtimin gjeologjik të rajonit të gjerë e përbëjnë:

- sedimente e kuaternarit
- sedimentët e kretakut të sipërme.

Formacioni karbonatorë i kretakut të sipërm (K2) - Sedimentet e Kretës së lartë janë të zhvilluar në rajonin e Strazhëutnë formë të brezave të gjerë të produkteve flishor dhe zonave relativisht të mëdha të gelqerorve të përcaktuara nga serpentinitet.

Gelqeroret masiv paraqesin sedimentet bazike të shtresave flishore të kretës së lartë. Gelqeroret masiv të plasarit ngjyrë hiri deri në hiri të mbyllt si dhe me nunca kah e bardha. Trashësia e tyre lëvizë nga 150-200m.

Kufijt me njësite tjera litostratigrafike janë kryesisht tektonik, shpesh të thyer në shkarje tërthore. Fauna në këtë shkëmbinjë është mirë e ruajtur. Veçohen gllotrukanat dhe rudistet.

Sedimentet flishore ndertojnë horizontet më të larta të kompleksit të kretakut të lartë. Seria e flishit karakterizohet me ndertim të tri katev litologjike: ranorve, mergeliteve dhe argjileve me varjatet e tyre. Në seri dallohen pjesët e poshtme ku dominon komponenti mergelor – argjilor dhe pjesët e sipërm kryesisht me komponentet ranore. Pjesët më të sipërm veçohen me ranor masiv.

Sedimentet e kuaternarit (Q) – Produktet kuaternare lajmërohen në formë të ëmbartjeve aluviale. Përfaqësohen nga rëra, zhavorri dhe suargjila në pjesën veriore. Për efekt të veprimitarisë tektonike ky regjion është mjaftë kompleks dhe e cila ka ndikuar në copëzimin e masës së mermerizuar të paleozoikut dhe gëlqerorëve.

Ndërtimi gjeologjik është i thjeshtë. Me të përhapurit janë gëlqeroret masiv që në pjesën periferike të tyre ndodhen gëlqerorët mergelor flishor ndërsa në pjesën e poshtme të prrockës shtrihen sedimentet aluviale si dhe rreshpet.

Gëlqeroret masiv (K23) janë të zhvilluar në një hapësirë relativisht të gjerë 6-7km. Dhe gjerësi disa qindra metra. Trashësia e gëlqerorit nuk është e përcaktuar, ndërsa nga të dhënat e shuarjeve të afërta trashësia kalon 100m. Këta gëlqeror janë masiv pa shtresime të theksuara ngjyrë hiri të çelet deri në të hirit të mbyllët.

Vetit e blloqeve gëlqerore në kuadër të një zone mobile gjeotektonike kanë bërë që ata gjatë evolucionit gjeodinamik të kores tokësore, në këto pjesë të pësoj deformime të shprehura në formë të qarjeve me gjenezë të ndryshme e cila mundë të shihet në strukturën mikroskopike të gëlqerorit.

Vendburimi ndërtohet nga këta anëtar litologjik:

- Seria gëlqerore
- Seria e serpentiniteve
- Argjila dhe prezenca rreshpeve.

Analizat kimike kanë treguar se përmbajtja e elementeve është në kondita të lejuara për shfrytëzim si që shihet më poshtë:

CaCO₃.....96.84% dhe

MgCO₃.....1.73%

Karakteristikat fiziko-mekanike të gëlqerorit të marruna nga gëlqerorët e vendburimit Kashani janë:

Pesha vëllimore2.69 g/cm³

Poroziteti.....3.82 %

Absorbimi.....0.22 %

Pozita gjeografike dhe topografike i objektit u përcaktua nga përshkrimet e më parshme.

Ndërtimi gjeologjik i vendburimit marrin pjesë gëlqeroret e triasikut të mesëm , të cilët alterohen me ndërfitje të thjerrëzave rreshpore .

Trashësia e pakos gëlqerore është më e madhe se sa thellësia maksimale e objektit për të cilën llogariten rezervat . Elementet si shtrirja ,rënja e gëlqerorit janë të rregullta pa ndërfitje tektonike.

Shkëmbinjte karbonatike janë grupi më i përhapur i shkëmbinjve sedimentar ku bëjnë pjesë gëlqeroret me këtë përbërje kimike:

Ca –54.7-56%

CaCO₃-0.0-2.3%

MgO- 0.0-2.3%

Vendburimi në Korroticë të Epërme në aspektin gjeologjik është i përbërë nga:

- Gëlqeroret e triasikut (T23)
- Gëlqeroret e mermeritizuar,
- Argjila e kuqe
- Mbules diluviale.

Ne ndërtimin e vendburimit dominojnë gëlqerorët e triasikut që kanë shtrirje dhe pjesëmarrje me te madhe. Gëlqeroret shtresore me drejtim të shtrirjes me azimut VP-JL.

450 -250

Vendburimi i gurit gëlqeror në objektin e kërkuar bënë pjesë në strukturën antiklinale. Ky vendburim nderohet nga gëlqeroret e triasikut së sipërm që kanë dalje në sipërfaqe .

Gëlqerorët e këtij vendburimi i përkasin tipit kalimtar. Këta shkëmbinj të emërtohen në bazë të llojit të kokrrizave .Zakonisht lënda lidhëse është kalçiti shpatik.

Këto depozitime janë kryesisht gëlqeror me një shkallë të mermeritizimit. Në vendburim i takojmë gëlqerorët me ngjyrë të bardhë me nuance bezhe.

Kufiri gjeologjik është brenda parcelës së lejuar për eksploatim. Nga këto të dhëna dallojmë gëlqeror ngjyrë të kuqërremet dhe gëlqeroret gri ngjyrë të bardh.

Gëlqeroret ngjyrë të kuqërremët . Struktura e këtyre gëlqerorëve është e shprehur me prezencë të qarjeve .Predominon ngjyra gri e mbyllët , janë kompakt dhe brenda tyre dallohen damarë të holla kalçiti me trashësi disa cm.

Në pakon e vendburimit takojmë shtresa gëlqerore me ngjyrë bezhe në të kuqërremt që trashësia sillet deri në 15cm. Kjo shtresë është e lidhur dobët me procesin e dollimitizimit të gëlqerove. Ngjyra e kuqe rrjedh nga prezenca e getitit.

Gëlqeroret Bllokor me ngjyrë gri të bardh. Këta gëlqeror janë shtresor me prezencë të madhe të mikroqarjeve . Ky lloj i gëlqerorit përfaqëson pjesën më të madhe të trupit mineral. Ngjyra e shkëmbinjve është gri e bardhë dhe vende me nuance bezhe.

Nderimi struktural i trupi është i ndërthurur me gëlqeror shtresor dhe blloqe me prezent të qarjeve që në sipërfaqe janë të mbushura me produkte të kuaternarit .

Prezenca e qarjeve në gëlqeror e bënë që në trashësinë deri 0.5m në sipërfaqe të ketë koncentrim të masave argjilore , që kjo në fazën fillestare dotë ja ulë pastërtinë e gurit gëlqeror gjegjësisht rritë masën sterile që duhet të ndahet gjatë procesit të seperimit të gurit gëlqeror. Masa e sterile sillet deri në masën 13.5% nga masa e përgjithshme e rezervave gjeologjike

Përbërja e gëlqerorit të pastër 56% CaO dhe 44% humbje në kalcium

Karakteristikat hidrogjeologjike të vendburimit të gëlqerorit janë të thjeshta . Gëlqeroret ndërtojnë një horst ashtu që një pjesë e ujërave sipërfaqësore drenohet në pjesët anësore të vendburimit e më tutje në prrockën e fshatit Strazhë, kurse lumi Bresallc ndodhet në distancë mbi 4 km.

Morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominant të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore.

Për deri sa dyshemenë e gëlqerorëve e ndërtojnë rreshtet bitit –muskovitë të cilët njihen me një ujëpërshkueshmëri shumë të dobët atëherë nëpër mjet qarjeve të gëlqerorëve këta ujëra mundë të akumulohen dhe të derdhen në prrockat përgjatë vendburimit apo nga ndonjë qarje tektonike të kemi burime.

Megjithatë në këtë lokacion ku është e vendosur vendburimi nuk kemi hasur burime të ujit përveç se në pjesën më jugore të vendburimit shihen rrjedhje të ujërave në prrockat në rrethin , kur ka të reshura atmosferike .

Në aspektin gjeotektonik rajoni i gjerë i takon zonës së Vardarit e cila karakterizohet me aktivitet të bujshëm tektono-magmatikë e në veçanti gjatë orogjenezës alpine të zhvilluar në këto zona të kores tokësore

Në kuadër të kësaj zone tektonike në regjionin e gjerë vërehen numër i madh i strukturave aplikative dhe disjunktive të cilat kanë pasur rëndësi në pozicionin hapësinor të brezave gëlqeror të kësaj zone.

4.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Për realizimin dhe operimin e projektit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror, furnizimi me ujë nuk do të bëhet nga rrjeti publik i ujës-jellësit. Uji i nevojshëm do të sigurohet përmes cisternave . Sipas lokacionit, në zonën përreth kalon Lumi Bresallc , i cili ndodhet në distancë rreth 338.98 m nga kufiri i parcelës ku

Figura 8. Distanca e projektit nga lumi Bresallc

4.6. Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë e mesme kontinentale.

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 9-10.5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 10°C.

Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C.

Temperaturat më të ulta kanë qenë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore për vitet e hulumtuara janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej (-1,7)-(-3,4°C).

Regjimi i reshjeve ne komunën e Novo Berdës ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 520 mm deri ne706 mm (për vitet e hulumtuara).

4.7. Karakteristikat natyrore

Rajoni i gjerë i Mihjes Sipërfaqësore e kompanisë Durimi karakterizohet me një relief kodrinorë –malore që kufizohet me vargmalet e grykës së Strazhëutme lartësi mbidetare nga 620m në deri 900m .

Vendburimi i gelqerorve shtrihet në terrenin kodrinoro- malor dhe shfrytëzimi planifikohet te behet prej 755-660m. Pika më të ulta janë ato që shtrihen në anën veriore të vendburimit (660m.) dhe anën jugor ngritet pika më të larta i ndertojnë grebenet të vendburimit. Këtu mbizotërojnë rendimentet e reja me konglomerat, sendimentet gëlqerore,

serpentinete etj. Ndërsa në rrafshina dominojnë sendimentet e materialit argjilor. Relievi me lartësitë, pjerrtësitë dhe format e tyre ndikojnë në ndërtimin e elementeve klimatike, në shfaqjen e rrjetit ujor dhe të bimsës. Pas përfundimit të projektit bëhet kultivimi i sipërfaqes së ekspluatuar.

4.8. Karakteristikat themelore të peizazhit

Peizazhi në zonën ku planifikohet ndërtimi dhe operimi i impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e shkëmbinjve të fort karakterizohet nga një ndërthurje e elementeve natyrore dhe atyre të transformuara nga aktivitetet njerëzore. Ky peizazh reflekton karakteristikat tipike të mjedisit në Komunën e Novo Berdës, ku ndërveprojnë relievi, vegetacioni dhe ndërhyrjet industriale. Relievi dhe struktura vizuale - Zona është kryesisht kodrinore dhe pjerrësore, me formacione të relievit që krijojnë lëndë panoramike me figura natyrore dhe në të njëjtën kohë me segmente të prekura nga aktivitete industriale të mëparshme. Për nga pamja, peizazhi prezantohet si një vijë kontinue e gjelbërimit natyror me zona të hapura tokësore dhe shtresa të shkëmbinjve në sipërfaqe. Harmonia natyrore dhe identiteti i zones - Pavarësisht ndërhyrjeve, peizazhi ruan elemente kryesore natyrore si mbulesa bimore, shkurre dhe pjerrësi natyrale që krijojnë një mjedis i karakterizuar nga kontrasti midis natyrës dhe aktivitetit njerëzor. Relievi dhe vegetacioni kontribuojnë në krijimin e një strukture vizuale ku elementet natyrore janë dominante, por komponentët industrialë janë të dukshëm në disa segmente të territorit. Vlerësimi i ndikimit vizual të projektit - Vendosja e impiantit do të krijojë një element të ri në peizazh, por duke qenë se zona është tashmë e karakterizuar nga aktivitete të ngjashme industriale dhe ndërhyrje në reliev, impakti vizual pritet të jetë i kufizuar dhe i integrueshëm. Për më tepër, masat e planifikuara për rehabilitim të zonave të punës dhe menaxhim të materialeve do të ndihmojnë në një integrim më të mirë të impiantit në peizazh, duke minimizuar efektet negative estetike. Në përgjithësi, peizazhi i zonës është i shumëllojshëm, kombinon elemente natyrore me ato të veprimtarisë industriale dhe nuk paraqet karakteristika të jashtëzakonshme natyrore që kërkojnë mbrojtje të veçantë, por kërkon menaxhim të kujdesshëm për të ruajtur balancin midis zhvillimit dhe vizualitetit natyror.

4.9. Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Novobërda ndodhet rreth 40 km në lindje të kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës. Historia e saj daton qysh nga koha e neolitit ose thënë ndryshe para Krishtit ndërsa vlera historike që e i jep kuptim Novobërdës ose thënë ndryshe si katalizator i vizitorëve është Kalaja, një

monument tejet i veçantë ku prej saj shihen tri komuna si në pëllëmbë të dorës, kjo Kala daton përafërsisht në shekullin e 12 dhe 13-të sipas analizave karbonike të drunjtëve që janë bërë ku këta drunjë thuhet se kanë qenë të periudhës 1230 – 1260 por edhe më herët.

Përveç Kalasë, Novobërdën e veçojnë dhe monumentet e kategorisë së veçantë si xhamia, katedralja e Shën Nikollës, Kishën e Shën Gjonit, Kishën saksone. Novobërda pra ngërthen në vete edhe bukuritë natyrore, po e theksojmë se atë e veçon kodra e madhe që njihet për lartësi mbidetare deri 1260m, është pika në pjesën lindore, shumë e përshtatshme për hiking në terren, po ashtu minierat e vjetra, boshtet e ventilimit si dhe drurin e veçantë mështeknën që rritet në Novobërdë.

Në rrethinën e zonës ku kompanija synon ye zhvilloj aktivitetet minerare nuk ka monumente te mbrojtura.

4.10. Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike

Komuna e Artanës ndodhet në juglindje të Kosovës. Kufizohet me Prishtinën në veri, Dardanën në lindje, Gjilanin në jug dhe Lipjanin në perëndim. Ka gjithsej 25 fshatra në komunë. Zona e përgjithshme e komunës ka një sipërfaqe prej 204.25 km². Së bashku me komunitat e Dardanës, Klokotit, Parteshit, Ranilugut, Vitisë dhe Gjilanit, formon rrethin e Gjilanit.

Regjistrimi i vitit 2011 tregoi se komuna e Artanës kishte një popullsi prej 6.729, nga të cilët 3.524 ishin shqiptarë, 3,122 serbë, 63 romë, 29 goranë, 7 turq, 5 boshnjakë dhe 3 ashkali.

4.11. Të dhënat për objektet ekzistuese

Në afërsi të lokacionit ku është planifikuar ndërtimi dhe operimi i impiantit për shfrytëzim, përpunimin, thërrmimin dhe separimin e shkëmbinjve të fort, janë identifikuar disa objekte dhe veprimtari ekzistuese, të cilat janë marrë parasysh në vlerësimin hapësinor dhe mjedisor të projektit. Bazuar në analizën e distancave dhe planimetrinë përkatëse, veprimtaria më e afërt ekzistuese është një aktivitet i ngjashëm industrial, i cili ndodhet në një distancë prej rreth 285 m nga kufiri i parcelës së projektit. Prania e kësaj veprimtarie tregon se zona është tashmë e destinuar dhe e adaptuar për aktivitete industriale, çka e bën lokacionin të përshtatshëm për realizimin e projektit të propozuar. Objektet e tjera të identifikuara në zonën më të gjerë përreth janë:

Figura 10. Distanca me biznese tjera

4.12. Në Zonat me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit

Bazuar në analizën e dokumentacionit planifikues në fuqi, gjendjen ekzistuese në terren, si dhe të dhënat në dispozicion për zonën ku është planifikuar ndërtimi dhe operimi i impiantit për shfrytëzim - përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gelqerorve, në hapësirën e projektit dhe në afërsi të drejtpërdrejtë të saj nuk janë identifikuar zona me vlera të veçanta shkencore, vende arkeologjike të regjistruara, apo zona veçanërisht të ndjeshme mjedisore që do të mund të ndikoheshin nga realizimi i projektit.

5. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

5.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Rajoni i gjerë i Mihjes Sipërfaqësore e kompanisë Durimi karakterizohet me një relief kodrinorë –malore që kufizohet me vargmalet e grykës së Strzhës me lartësi mbidetare nga 620m në luginën e deri 900m

Brenda zonës së hulumtimeve, mjedisi është i pa degraduar, por zonat përreth janë të hulumtuara dhe shfrytëzohen nga operatorët tjerë të licencuar

Degradimi i mjedisit - Problemet kryesore mjedisore të identifikuara përfshijnë ndotjen e ajrit, ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotjen e tokës nga deponitë ilegale të mbeturinave, dëmtimin e peizazhit nga aktivitetet e gurëthyesve, degradimin e pyjeve përmes prerjeve ilegale, si dhe humbjen e tokës bujqësore për shkak të ndërtimeve të paligjshme.

Ndotja e ajrit - Në aktivitetin e mihjes sipërfaqësore, ndikim negativ në mjedis shprehet edhe në ambientin e ajrit. Në zonën e shtrirjes së trupit mineral ajri është i pastër. Deri te ndotja vjen për shkak të punëve dhe aktivitetit në mihjen sipërfaqësore, sidomos në fazën e shpimit, minimin, ngarkimit dhe transportit. Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës, por duke iu falënderuar formës së relievit dhe konfiguracionit të terrenit bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrin deri te vendbanimet e banuara më të afërta, pasi se ato janë larg nga lokacioni ku do të eksploatohet guri gëlqeror.

Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimimit të gazrave nga garnitura shpuese e cila nevojitet për shpimin e vrimave për minim, nga automjetet e ngarkimit dhe transportit të cilat si lëndë djegëse përdorin derivatet e naftës.

Përbërja e gëlqerorit në shfrytëzim nuk përmban materie të dëmshme.

Ndotja e ujit - Burimi kryesor i ndotjes së ujërave në komunë janë ujërat e zeza të patrajtuara, si pasojë e sistemit të papërfunduar të kanalizimit. Këto ujëra shkarkohen drejtpërdrejt në lumenjtë Bresallc , duke ndikuar negativisht në cilësinë e ujit dhe ekosi stemet ujore. Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuset e më sipërm të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore. Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor. Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj.

Ndotja e tokës - Ndotja e tokës në komunë lidhet kryesisht me deponitë ilegale të mbeturinave shtëpiake dhe mbetjeve të ndërtimit, të cilat janë të shpërndara përgjatë rrugëve dhe në zona periferike. Këto deponi shkaktojnë kontaminim të drejtpërdrejtë të tokës, si dhe ndotje sekondare të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore përmes reshjeve. Një formë tjetër e degradimit të tokës është ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, si dhe prerja ilegale e pyjeve.

Ndotja akustike - Zhurma, si element në teknologjinë e eksplotimit të gurit gëlqeror ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara, duke pasur parasysh largësinë e tyre nga lokacioni. Zhurma vjen si rezultat i aktiviteteve minerare kryesisht nga makinat gjatë procesit të shpimit, minimi ngarkimit, transportit etj. Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese bashkohore në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim duhet të jetë 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës do të punohet, por edhe kur punohet nuk është më e madhe se 45 dB. Ne vijim po e paraqesim ne formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db –niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Rreziqet natyrore dhe fatkeqësitë - Komuna e Novo Berdës është e ekspozuar ndaj rreziqeve natyrore si vërshimet, rrëshqitjet e dheut, erozioni, tërmetet dhe zjarret. Vërshimet përgjatë lumit Bresalle kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në të kaluarën, veçanërisht në tokat bujqësore. Erozioni është i përhapur në një pjesë të madhe të territorit komunal, ndërsa territori bën pjesë në zonë sizmike me intensitet 7 –8 gradë sipas shkallës MSC. Numri i zjarreve, veçanërisht atyre malore, është mbi mesataren e Kosovës, për shkak të karakterit malor të komunës dhe kapaciteteve të kufizuara për ndërhyrje.

6. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

6.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Shfrytëzimi seperiimi dhe perpunimi i gurit gëlqeror dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare ku është planifikuar të bëhet zgjerimi i fushës eksplatare ndodhen në pjesët e ngastrave kadastrale Qertifikata nr.00673-1dhe 00673-2 ngastrat P-72403058-00673-1 DHE P-72403058-00673-2, numri i certifikates 128/2024 dt 05.02.2024 në Strazhë Komuna Novo Berde me sip S=50546m2 me kulturë kullosë klasa 6 dhe mal kl 4

, është e përkufizuar me kufijtë dhe koordinatat e paraqitura ne dokumentacionin e bashkangjitur raportit të VNM-së dhe do te shënohen në vijim.

Pronari I kompanisë dhe Stafi I saj kanë punuar një kohë të gjatë në këtë veprimtari dhe është I interesuar që përvojen e ushtruar në këtë fushë deri më tani ta implementoj dhe përfeksionoj në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të gëlqërorëve veçanti dhe resurseve minerale në përgjithësi për nevojat e industrisë së ndërrimit në Kosovë. Për këtë arsye prej disa viteve është duke bërë përpjekje që të investoj në zhvillimin dhe nrgjerimin e kapaciteteve të reja për prodhimin e lëndëve të para në industrinë e ndërrimit, me një teknologji të avancuar, e cila ka si kriter kryesor ka mbrojtjen e mjedisit jetësor ku zhvillohen këto aktivitete.

Përzgjedhja e keti VB ne Stazhë te komunes se Novoberdes do të përfshijë këto tërësi tematike:

- Të dhënat e përgjithshme mbi vendburimin
- Nevojat ne rritje për fraksione
- Llogaritja e rezervave
- Vlerësimi I Vendburimit

Per zvogëlimin e shpenzimeve janë shqyrtuar disa alternativa të realizueshme për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme:

A. Ndërtimi i sistemit solar fotovoltaik me integrim të sistemit të ruajtjes së energjisë në lokacionin e propozuar.

B. Ndërtimi i sistemit solar pa sistem të ruajtjes së energjisë.

Alternativa kryesore e analizuar është ndërtimi i një sistemi solar fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, i kombinuar me sistem të ruajtjes së energjisë prej 30 MWh në lokacionin e propozuar. Si alternativa të tjera janë shqyrtuar ndërtimi i sistemi t pa bateri dhe zhvendosja e projektit në lokacione alternative. Të gjitha alternativat janë vlerësuar nga aspekti teknik, mjedisor, ekonomik dhe funksional. Alternativa (a) është vlerësuar si më e përshtatshme teknikisht dhe mjedisorisht.

6.2. Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës së propozuar

Alternativa e përzgjedhur vlerësohet si më e përshtatshme, pasi ofron balancën më të mirë ndërmjet funksionalitetit teknik, ndikimit të kontrolluar mjedisor dhe kostos ekonomike. Lokacioni i propozuar ka kushte të përshtatshme për këtë lloj aktiviteti, është i aksesueshëm nga infrastruktura rrugore ekzistuese dhe ndodhet larg zonave të banuara. Po ashtu, alternativa e zgjedhur shmang nevojën për ndërhyrje të reja në zona të paprekura dhe mundëson zhvillimin e aktivitetit industrial në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme.

6.3. Vendndodhja ose rruga

Vendndodhja e projektit në Strazhë, Komuna e Novo Berdës, vlerësohet si e përshtatshme për shkak të karakteristikave gjeologjike, distancës dhe qasjes në infrastrukturën ekzistuese rrugore.

6.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Gjatë fazës së ndërtimit priten ndikime të përkohshme si pluhur, zhurmë dhe lëvizje e mjeteve të rënda. Këto ndikime janë të kufizuara në kohë dhe hapësirë dhe do të menaxhohen përmes masave parandaluese. Gjatë fazës së operimit, ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut janë të kontrollueshme dhe mbahen brenda kufijve të lejuar, pasi procesi është mekanik, pa përdorim të substancave kimike të rrezikshme dhe pa gjenerim të ujërave të ndotura teknologjike.

6.5. Proceset dhe teknologjia e prodhimit

Procesi i prodhimit në impiantin për shfrytëzim, përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror bazohet në teknologji mekanike, pa përdorim të proceseve kimike apo djegies. Lënda e parë, guri i fortë, pranohet në impiant dhe futet në linjën e përpunimit përmes bunkerëve të furnizimit dhe ushqyesve mekanikë, të cilët sigurojnë dozimin e kontrolluar të materialit. Në fazën e parë realizohet thërrmimi primar, ku materiali reduktohet në dimensione më të vogla përmes thërrmuesve industrialë. Materiali i thërrmuar kalon më pas në sita vibruese, ku kryhet klasifikimi sipas madhësisë së grimcave. Fraksionet që nuk plotësojnë kërkesat granulometrike rikthehen në proces për thërrmim të mëtejshëm. Në fazën

pasuese realizohet thërrmimi sekondar dhe, sipas nevojës, sitja finale, me qëllim prodhimin e fraksioneve të ndryshme të agregateve ndërtimore. Transporti i materialit ndërmjet fazave të procesit kryhet përmes transportuesve me rripa, të cilët sig urojnë rrjedhë të vazhdueshme dhe të kontrolluar. Gjatë gjithë procesit teknologjik zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, kryesisht përmes spërkatjes me ujë në pikat kritike të përpunimit. Procesi nuk gjeneron ujëra të ndotura teknologjike dhe nuk prodhon emetime ndotëse nga djegia. Teknologjia e zgjedhur siguron prodhim efikas, cilësi të qëndrueshme të produkteve dhe ndikime mjedisore të menaxhueshme, duke e bërë projektin të përshtatshëm për funksionim afatgjatë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore.

6.6. Metodatat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit

Punimet realizohen me makineri dhe pajisje industriale standarde, duke respektuar masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Gjatë funksionimit, impianti do të operohet në mënyrë të organizuar, me mirëmbajtje të rregullt dhe kontroll teknik të pajisjeve .

6.7. Plani i lokacionit

Plani i lokacionit përfshin organizimin funksional të impiantit, zonat e përpunimit, rrugët e brendshme, trafostacionin dhe hapësirat ndihmëse.

6.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Për realizimin e projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror do të përdoren materiale ndërtimore dhe industriale standarde, të përzgjedhura në përputhje me kërkesat teknike, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit. Materialet kryesore përfshijnë konstruksione çeliku dhe beton të armuar për bazamentet e pajisjeve dhe infrastrukturën mbështetëse, të cilat sigurojnë stabilitet dhe qëndrueshmëri të impiantit. Për ndërtimin e rrugëve të brendshme dhe sipërfaqeve funksionale do të përdoren materiale inerte dhe agregate të përshtatshme. Pajisjet teknologjike, si thërrmuesit, sitat vibruese, transportuesit me rripa dhe sistemi i automatizimit, janë të prodhuara nga materiale rezistente ndaj konsumit dhe të certifikuara për përdorim industrial. Materialet ndihmëse, përfshirë elementet elekt rike dhe instalimet teknike, përzgjidhen sipas standardeve përkatëse dhe kërkesave ligjore. Përzgjedhja e materialeve është bërë me qëllim të sigurimit të jetëgjatësisë së impiantit, funksionimit të sigurt dhe minimizimit të ndikimeve mjedisore gjatë ndërtimit dhe operimit të projektit.

6.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Faza e ndërtimit parashihet të realizohet brenda një periudhe prej 3 –6 muaj, duke përfshirë punimet përgatitore, ndërtimin e infrastrukturës dhe instalimin e pajisjeve teknologjike . Pas përfundimit të ndërtimit dhe testimit të pajisjeve, projekti kalon në fazën e operimit , e cila është planifikuar të zgjasë afatgjatë, në përputhje me vlefshmërinë e lejeve mjedisore dhe ndërtimore, si dhe me kushtet e përcaktuara në to. Funksionimi i impiantit do të vazhdojë për aq kohë sa plotësohen kërkesat ligjore, teknike dhe mjedisore

6.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Madhësia e lokacionit është e përshtatshme për vendosjen e impiantit dhe infrastrukturës përcjellëse, pa zgjerime të panevojshme. Sipërfaqja në të cilën do të shtrihet impiante është 50000 m².

6.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i prodhimit të impiantit për shfrytëzim, përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror është përcaktuar në përputhje me kapacitetin teknik të pajisjeve të instaluar dhe organizimin e punës. Impianti është projektuar të funksionojë me kapacitet maksimal prej rreth 500 –650 ton/orë, në varësi të karakteristikave të materialit hyrës dhe kushteve operative.

6.12. Kontrolli i ndotjes

Janë parashikuar masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe ndikimeve të tjera mjedisore.

6.13. Trajtimin e mbeturinave

Nuk parashihet trajtim i mbeturinave në lokacion. Mbeturinat komunale merren nga kompania e kontraktuar nga Komuna.

6.14. Infrastruktura rrugore dhe qasja

Qasja realizohet përmes infrastrukturës ekzistuese rrugore, e cila është e zhvilluar dhe e mjaftueshme.

6.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit

Zbatuesi i projektit është përgjegjës për respektimin e të gjitha kërkesave mjedisore, zbatimin e masave parandaluese dhe raportimin ndaj autoriteteve kompetente.

6.16. Trajnimi

Personeli do të trajnohet për përdorimin e pajisjeve, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtje nga zjarri.

6.17. Monitorimi

Monitorimi i parametrave mjedisore do të realizohet periodikisht, sipas kërkesave ligjore.

6.18. Planet për situata emergjente

Janë parashikuar procedura për reagim në raste emergjente, përfshirë zjarrin dhe ndaljen e pajisjeve.

6.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Në përfundim të jetës operative, pajisjet do të çmontohen dhe lokacioni do të rehabilitohet, duke rikthyer zonën në gjendje të përafërt me atë para realizimit të projektit.

6.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani përfshin masa parandaluese, monitoruese dhe korrektuese për të gjitha fazat e projektit, me qëllim minimizimin e ndikimeve negative.

6.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim

Alternativa pa veprim nënkupton mosrealizimin e projektit, pa ndikime të reja mjedisore, por edhe pa përfitime ekonomike dhe sociale .

7. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis përfshin analizimin e mënyrës se si aktivitetet e planifikuara në kuadër të projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e shkëmbinjve të fort të kompanisë “Durimi” SH.P.K. ndikojnë në komponentët kryesorë mjedisorë. Ky kapitull paraqet një vlerësim të detajuar të ndikimeve të mundshme që mund të shfaqen gjatë fazës së ndërtimit, operimit . Analiza e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është realizuar duke u bazuar në dokumentacionin teknik të projektit, karakteristikat fizike dhe mjedisore të lokacionit, si dhe në gjendjen ekzistuese të zonës ku planifikohet të zbatohet projekti. Vlerësimi është kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikatat e mira të projekteve industriale për përpunimin e materialeve minerale. Ndikimet e projektit janë analizuar në raport me tre aspekte kryesore të mjedisit:

- aspektet fizike dhe kimike, të cilat përfshijnë ndikimet në ajër, tokë, ujë, zhurmë, relief dhe përdorimin e burimeve natyrore, si dhe ndryshimet fizike të terrenit gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit;
- aspektet biologjike dhe ekologjike, që lidhen me ndikimet e mundshme në florë, faunë dhe biodiversitetin lokal, duke marrë parasysh karakterin e zonës dhe mungesën e habitateve të mbrojtura në afërsi të drejtpërdrejtë;
- aspektet socio -ekonomike, të cilat përfshijnë ndikimet në komunitetin lokal, vendbanimet, punësimin, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të zonës. Duke qenë se impianti do të funksionon kryesisht përmes proceseve mekanike dhe nuk përfshin procese djegieje apo përdorim të substancave kimike të rrezikshme, ndikimet mjedisore gjatë fazës së operimit vlerësohen si të kontrollueshme dhe brenda kufijve të pranueshëm. Projekti nuk gje neron ujëra të ndotura teknologjike dhe emetimet në ajër dhe zhurmë menaxhohen përmes masave teknike dhe organizative. Ndikimet kryesore pritet të shfaqen gjatë fazës së ndërtimit dhe janë të përkohshme, të lokalizuara dhe të me naxhueshme. Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është të sigurojë që projekti të realizohet në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe duke garantuar zhvillim të kontrolluar të aktivitetit industrial.

7.1. Ndikimet në ajër gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit

Gjatë shfrytëzimit, përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e lidhen drejtpërdrejt me punimet ndërtimore dhe proceset mekanike të funksionimit të impiantit. Në fazën e ndërtimit, përgatitja e terrenit, gërmimet, nivelimi dhe qarkullimi i makinerive të rënda mund të shkaktojnë ngritje të përkohshme të pluhurit në ajër. Pluhuri përbëhet kryesisht nga grimca të pezulluara PM₁₀ dhe PM_{2.5} dhe shfaqet kryesisht gjatë periudhave të thata. Po ashtu gjatë qarkullimit të makinave lirohen emetime të zankonshme djegie CO₂, NO_x, CO dhe hidrokarbure. Këto ndikim janë të kufizuar në zonën e punimeve, zgjat vetëm gjatë fazës ndërtimore dhe pushon pas përfundimit të saj. Në fazën e operimit, burimi kryesor i ndikimit në ajër është pluhuri i krijuar gjatë thërrmimit, sitjes, ngarkimit dhe lëvizjes së shkëmbinjëve të forte brenda impiantit. Po ashtu, mjetet dhe pajisjet që përdorin karburant gjenerojnë emetime të zakonshme nga djegia, si CO₂, NO_x, CO dhe hidrokarbure. Këto emetime janë të natyrës lokale, kontrollohen përmes masave teknike dhe nuk pritet të shkaktojnë përkeqësim të ndjeshëm të cilësisë së ajrit jashtë zonës së impiantit. Gjatë fazës së demolimit ose çmontimit të pajisjeve, ndikimet në ajër lidhen me pluhurin e krijuar nga çmontimi i strukturave dhe lëvizja e mjeteve mekanike. Këto ndikime janë të përkohshme dhe do të menaxhohen përmes masave të ngjashme me fazën e ndërtimit, duke përfshirë lagjen e sipërfaqeve dhe organizimin e kontrolluar të punimeve.

7.2. Ndikimet në tokë gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit

Si ndikim negativ në tokë paraqitet masa sterile e cila duhet të largohet nga sipërfaqet e punës. Trashësia e sterilit sillet prej 15 cm gjerë 40 cm, depozitimi i tij duhet të bëhet në konsultim me projektuesin në zonën e punishtes, në një anë ku nuk pengon proceset minerare. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe me ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese. Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe punës së tyre. Ndikimet menaxhohen përmes organizimit të punimeve dhe stabilizimit të sipërfaqeve të prekura. Gjatë fazës së operimit, ndikimet në tokë janë të kufizuara dhe lidhen kryesisht me shfrytëzimin e sipërfaqes për vendosjen e pajisjeve, qarkullimin e mjeteve dhe depozitimin e përkohshëm të materialeve. Nuk parashikohet ndotje e tokës, pasi procesi teknologjik nuk përfshin përdorim të substancave të rrezikshme dhe nuk gjeneron ujëra të ndotura teknologjike. Rreziku i ndotjes së tokës nga karburantet dhe vajrat

minimizohet përmes ruajtjes dhe mirëmbajtjes së kontrolluar të makinerive . Gjatë fazës së çmontimit (demolimit) , Gjatë fazës së demolimit ose çmontimit të impiantit, ndikimet në tokë lidhen me lëvizjen e mjeteve të rënda dhe largimin e pajisjeve dhe strukturave. Këto ndikime janë të përkohshme dhe pas përfundimit të punimeve parashihet pastrimi dhe rehabilitimi i sipërfaqes së shfrytëzuar. Në përgjithësi, ndikimet në tokë gjatë të gjitha fazave të projektit vlerësohen si të kufizuara dhe të menaxhueshme, me zbatimin e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e tokës dhe ruajtjen e stabilitetit të terrenit.

7.3. Ndikimet në ujë gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit

Gjatë aktivitetit minerar, ndikimet në ujë lidhen kryesisht me rrjedhjet sipërfaqësore të përkohshme që mund të krijohen si pasojë e reshjeve dhe punimeve përgatitore të terrenit. Nuk parashihet shkarkim i ujërave të ndotura teknologjike. Rreziku i ndotjes së ujërave nga karburantet ose vajrat e makinerive është i ulët dhe menaxhohet përmes masave parandaluese dhe organizimit të kontrolluar të punimeve. Gjatë fazës së operimit , projekti nuk gjeneron ujëra të ndotura teknologjike, pasi procesi i përpunimit të gurit gëlqeror është mekanik dhe nuk përfshin përdorim të ujit në proces. Uji përdoret vetëm për kontrollin e pluhurit dhe për nevoja ndihmëse, pa shkarkim në mjedis. Si rrjedhojë, ndikimet në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore vlerësohen si minimale. Gjatë fazës së çmontimit (demolimit) të impiantit, ndikimet në ujë janë të ngjashme me ato të fazës së ndërtimit dhe lidhen kryesisht me rrjedhjet sipërfaqësore të përkohshme dhe lëvizjen e mjeteve mekanike. Pas përfundimit të punimeve parashihet pastrimi i lokacionit dhe rehabilitimi i sipërfaqes. Në përfundim, ndikimet në ujë gjatë të gjitha fazave të projektit janë të kufizuara, të përkohshme dhe të menaxhueshme, duke mos paraqitur rrezik të konsiderueshëm për burimet ujore lokale .

7.4. Ndikimi në pejzazh gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit

Lokacioni ku është mihja sipërfaqësore, gjithnjë do të merr pamjen e një vendi industrial. Gjatë fazës së shfrytëzimit normalisht, pejzazhi do të pësojë një degradim i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të shfrytëzimit do të kthehet pamja në harmoni me gjendjen të përafërt me gjendjen e mjedisit me rrethinën . Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensimin të shfrytëzimit të pasurive /resurseve natyrore. Ndikimet në pejzazh gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit vlerësohen të vogla, të përkohshme dhe plotësisht të rikuperueshme, pa pasoja të qëndrueshme në pamjen vizuale të zonës.

7.5.Ndikimi në florë dhe faunë gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në mihjen sipërfaqësore për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe ate ne sipërfaqet operacionale ne gjatësinë kohore të eksploatimit flora tërësisht do të shkatërrohet, e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve minerare. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

7.6.Ndikimi në nivelet e zhurmës gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit

Gjatë aktivitetit minerar, rritje e përkohshme e niveleve të zhurmës pritet si pasojë e punimeve ndërtimore, përdorimit të makinerive të rënda dhe qarkullimit të mjeteve transportuese. Këto zhurma janë të përkohshme, të kufizuara në kohë dhe hapësirë, dhe kryesisht gjatë orarit të punës ditore. Zhurma, si element në teknologjinë e eksploatimit të gurit gëlqeror ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara, duke pasur parasysh largësinë e tyre nga lokacioni.

Zhurma vjen si rezultat i aktiviteteve minerare kryesisht nga makinat gjatë procesit të shpimit, minimit ngarkimit, transportit etj.

Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese bashkohore në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim duhet të jetë 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës do të punohet, por edhe kur punohet nuk është më e madhe se 45 dB. Ne vijim po e paraqesim ne formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db –niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

7.7.Ndikimi social gjatë fazë së ndërtimit, operimit dhe demolimit

Gjatë aktivitetit minerar, projekti krijon ndikime sociale kryesisht pozitive, përmes angazhimit të punëtorëve lokalë dhe rritjes së aktivitetit ekonomik në zonë. Ndikime të

përkohshme negative mund të lidhen me rritjen e trafikut, zhurmën dhe shqetësimet afatshkurtra për banorët për rreth, të cilat vlerësohen si të kufizuara dhe të përkohshme. Gjatë fazës së operimit, projekti ka ndikim social pozitiv përmes krijimit të vendeve të qëndrueshme të punës dhe kontributit në zhvillimin ekonomik lokal. Aktiviteti i impiantit nuk parashikon zhvendosje të popullsisë dhe nuk ndikon negativisht në strukturën sociale të zonës. Ndikimet e mundshme, si trafiku dhe zhurma, janë të menaxhueshme dhe nuk pritet të ndikojnë në cilësinë e jetës së komunitetit. Gjatë fazës së çmontimit (demolimit), ndikimet sociale janë kryesisht të përkohshme dhe lidhen me ndërprerjen e aktivitetit dhe përfundimin e vendeve të punës. Këto ndikime janë të kufizuara në kohë dhe hapësirë dhe nuk parashikohen pasoja sociale afatgjata për komunitetin lokal. Në përgjithësi, ndikimi social i projektit vlerësohet si kryesisht pozitiv gjatë fazës së operimit dhe i menaxhueshëm gjatë fazave të ndërtimit dhe demolimit.

7.8.Ndikimet Kumulative

Vlerësimi i ndikimeve kumulative është bërë duk e marrë parasysh karakterin industrial të zonës, infrastrukturën ekzistuese dhe aktivitetet ekonomike përreth lokacionit në Strazhë, Komuna e Novo Berdës. Në aspektin e ajrit, ndikimet kumulative lidhen kryesisht me emetimet e pluhurit nga impianti dhe nga aktivitetet e tjera industriale ose transportuese në zonë. Me zbatimin e masave për kontrollin e pluhurit, ndikimi kumulativ në cilësinë e ajrit vlerësohet si i kufizuar dhe brenda kufijve të lejuar. Në aspektin e zhurmës, mund të ketë mbivendosje të zhurmës nga impianti me burime të tjera ekzistuese në zonë. Megjithatë, duke qenë se zona ka karakter kryesisht industrial dhe distancë nga zonat e banuara, ndikimi kumulativ i zhurmës vlerësohet si i menaxhueshëm. Sa i përket tokës dhe ujërave, projekti nuk gjeneron ujëra të ndotura teknologjike dhe nuk përdor substanca të rrezikshme, çka minimizon mundësinë e ndikimeve kumulative negative në këto elemente të mjedisit. Në aspektin social dhe ekonomik, ndikimet kumulative vlerësohen kryesisht pozitive, përmes krijimit të vendeve të punës dhe kontributit në zhvillimin ekonomik lokal, në kombinim me aktivitetet ekzistuese në zonë. Në përfundim, ndikimet kumulative të projektit, të marra së bashku me aktivitetet ekzistuese përreth, vlerësohen si të kufizuara dhe të menaxhueshme, pa krijuar rrezik të konsiderueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

7.9.Mbeturinat dhe masat e marrura gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit

Gjatë fazës së ndërtimit, do të krijohen sasi të kufizuara të mbeturinave ndërtimore, si mbetje inertesh, ambalazhe materialesh dhe mbeturina komunale nga personeli. Këto mbeturina grumbullohen në mënyrë të kontrolluar dhe dorëzohen tek operatorë të autorizuar,

ndërsa mbeturinat inerte mund të shfrytëzohen për nivelimin e terrenit brenda lokacionit . Gjatë fazës së operimit , nuk gjenerohen mbeturina nga procesi teknologjik që kërkojnë trajtim. Mbeturinat komunale të krijuara nga aktivitetet e përditshme të personelit grumbullohen veçmas dhe merren nga kompania e kontraktuar për grumbullimin e mbeturinave nga Komuna përkatëse. Gjatë fazës së çmontimit (demolimit) , do të mbeturina inerte dhe materiale ndërtimore. Këto mbeturina grumbullohen dhe menaxhohen në mënyrë të kontrolluar, me rikuperim ose dorëzim në lokacione të autorizuara, ndërsa sipërfaqja pastrohet dhe përgatitet për rehabilitim. Me zbatimin e këtyre masave, menaxhimi i mbeturinave gjatë të gjitha fazave të projektit realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pa ndikime të konsiderueshme në mjedis .

8. PËRSHKRIMI I MASA VE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

Në bazë të analizës së kryer mbi ndikimet mjedisore të projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzimin , përpunimin, thërrmimin dhe sep erimin e shkëmbinjve të fort të kompanisë “Durimi” SH.P.K ., si dhe duke u mbështetur në projektin teknik dhe vlerësimet e paraqitura në këtë raport, vlerësohet se aktiviteti i planifikuar nuk paraqet rrezik të konsiderueshëm për mjedisin jetësor, me kusht që të zbatohen masat mbrojtëse të parapara. Proceset teknologjike të impiantit janë kryesisht mekanike dhe zhvillohen në kushte të kontrolluara, në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi. Aktiviteti nuk përfshin procese djegieje industriale, nuk përdor substanca kimike të rrezikshme dhe nuk gjeneron ujëra të ndotura teknologjike. Ndikimet mjedisore janë të kufizuara kryesisht në fazën e ndërtimit dhe janë të përkohshme si dhe ndikime të vogla në fazën e operimit , të lokalizuara dhe të menaxhueshme përmes zbatimit të masave përkatëse mbrojtëse. Masat për mbrojtjen e mjedisit do të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të impiantit, me qëllim të parandalimit, reduktimit ose eliminimit të çdo ndikimi të mundshëm negativ në ajër, tokë, ujë, zhurmë, peizazh dhe biodiversitet. Këto masa do të sigurojnë respektimin e vlerave kufitare të lejuara ligjore për emetimet e pluhurit dhe zhurmës, si dhe menaxhimin e rregullt të mbeturinave dhe mbrojtjen e tokës dhe ujërave. Për të garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, operatori i impiantit do të zbatojë praktika të mira të menaxhimit mjedisor dhe të sigurisë teknike, duke përfshirë mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve, organizimin e kontrolluar të aktivitetit , monitorimin e ndikimeve kryesore mjedisore dhe zbatimin e procedurave të qarta për reagim në situata të jashtëzakonshme. Këto masa sigurojnë funksionim të qëndrueshëm, të sigurt dhe mjedisorisht të përgjegjshëm të impiantit gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.

8.1.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative të mundshme në ajër të krijuara nga realizimi i proceseve teknologjike për eksploatin e gurit gëlqeror të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Në mihjen sipërfaqësore, gjatë punës me garniturë shpuese duhet rregullisht të aplikohet thithësi i pluhurit, gypi i thithësit të pluhurit duhet të vendoset ne skaj të vrimës që shpohet për të grumbulluar pluhurin e liruar ne thes për pluhur.
- Nuk duhet të minohet në kohëra me erëra.
- Të gjitha sipërfaqet operationale dhe rrugët (pjesët e pa asfaltuara) ku do të bëhet transportimi i masës shkëmbore duhet vazhdimisht të stërpiken me ujë.
- Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda punuese me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate.
- Duhet rregullisht të jetë ne disponim cisterna me ujë rezervë.


8.2.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Mbrojtja e mihjes sipërfaqësore nga ndotësit e ngurtë të cilët mund të ndodhin gjatë bartjes me ujë nga të reshurat atmosferike duhet të bëhet me krijimin e kanalit rreth e përçark sipërfaqes së mihjes sipërfaqësore. Ky kanal nevojitet për mbrojtjen e mihjes sipërfaqësore nga vërshimet gjatë të reshurave atmosferike, dhe mbrojtjen e ujërave nga ndotësit mekanik dhe ndotësit me vajra e derivate, prandaj për pastrimin e ujërave të cilët rrjedhin nga hapësirat e mihjes sipërfaqësore gjatë të reshurave atmosferike duhet të rregullohen pusët sedimentuese për sedimentimin e materieve të ngurta dhe seperatori për pastrimin e ujit të ndotur me vajra e derivate të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operationale të mihjes sipërfaqësore, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e pastra të lëshohen në recipient. Duhet rregullisht të pastrohen pusët sedimentuese dhe seperatori. Në mihjen sipërfaqësore gjithmonë duhet të ketë në disponim absorbues të vajrave dhe derivateve.

Ujërat e zeza duhet së pari te trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet në varshmëri me numrin e punëtorëve e pastaj të lirohen ne recipient të pastërta. Gropa septike duhet të pastrohet nga pronari apo kompanitë e licencuara

Ne vijim po e paraqesim shemën teknologjike të trajtimit të ujërave të ndotura.

Shema teknologjike e trajtimit të ujërave



8.3.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë nga realizimi i proceseve teknologjike për eksploatimin e gurit gëlqeror duhet marrë këto masa mbrojtëse:

- Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuar për shfrytëzim të mëtutjeshëm si dhe mos të lejohet kalbja e tyre.
- Pjesën humusore dhe argjilore të materialit steril duhet deponuar në vende të posaçëm me qëllim të ruajtjes për rekultivim biologjik.
- Erozionin duhet ta pengojmë me anë të rikultivimit biologjik ku është e mundur.
- Varësisht nga fronti i punëve në minierë, në kohën më të shkurtër që është e mundur duhet të filloi procesi i rikultivimit, me ç’ rast e tërë sasia e sterilit e cila mbetet do të përdoret për mbushje dhe nivelizim të hapësirave të krijuara nga proceset e shfrytëzimit të gurit gëlqeror.
- Të ndërpritet puna në kohra me të reshura atmosferike me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës.

- Duhet të merën masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Vaji i makinave duhet të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë dhe ate ne ofiçinën për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese.
- Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin e eksploatimit të gurit gëlqeror për shkak te avarive ne makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në minierë duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe lloit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara, për mbeturinat tjera të ngurta të sigurohen kontinierë të posaçëm të cilët do të i zbrazin kompanitë që kanë veprimtarin e grumbullimit të tyre dhe të i dërgojnë ne deponin regjionale.
- Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaçme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

8.4.Masat për mbrojtje nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me ligjet dhe nivelet e lejuara për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merën të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e të lejuarës sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

8.5.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh

Gjatë fazës së ndërtimit , punimet do të kufizohen vetëm në sipërfaqet e nevojshme për realizimin e projektit, duke shmangur ndërhyrjet e panevojshme në relievin natyror. Materialet ndërtimore dhe pajisjet do të sistemohen në mënyrë të rregullt për të reduktuar

ndikimin vizual. Gjatë fazës së operimit , lokacioni do të mirëmbahen rregullisht, duke përfshirë pastrimin e zonave të punës dhe menaxhimin e rregullt të sipërfaqeve funksionale. Organizimi i impiantit dhe infrastruktura e brendshme do të kontribuojnë në minimizimin e ndikimit vizual në peizazh. Gjatë fazës së demolimit , pas çmontimit të pajisjeve dhe strukturave, parashihet pastrimi i plotë i lokacionit dhe rehabilitimi i sipërfaqes së shfrytëzuar, me qëllim rikthimin e terrenit në një gjendje të përshtatshme dhe të integruar me mjedisin përreth. Zbatimi i këtyre masave siguron që ndikimi në peizazh të jetë i kufizuar dhe i menaxhueshëm gjatë të gjitha fazave të projektit.

8.6.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në florë dhe faunë

Do të evitohet pastrimi i panevojshëm i tokës dhe ndërhyrjet jashtë zonës së projektit, me qëllim ruajtjen e habitateve ekzistuese. Meqë kompania „Durimi”, nga komuniteti ka respekt, për arsye të zbutjes së papunësisë në këte lokalitet të varfër , duke pasur parasysh llojin e projektit, kapacitetin e prodhimit dhe potencialit të ndikimeve në mjedis, nuk ka pasur dhe nuk planifikon që të ketë ndonjë debat të ngushtë publik apo edhe të veçantë me publikun.

8.7. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Gjatë fazës së operimit , aktiviteti i impiantit do të kufizohet brenda lokacionit të projektit, ndërsa masat për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës do të zbatohen vazhdimisht. Qarkullimi i mjeteve do të menaxhohet për të shmangur ngarkesën e panevojshme në rrugët lokale. Gjatë fazës së demolimit , masat për mbrojtjen e vendbanimeve dhe popullatës do të jenë të ngjashme me ato të fazës së ndërtimit, duke përfshirë organizimin e punimeve dhe informimin e nevojshëm të komunitetit lokal. Zbatimi i këtyre masave siguron që ndikimet në vendbanime dhe popullatë të mbahen në nivele të pranueshme dhe të mos shkaktojnë shqetësime të konsiderueshme për komunitetin lokal.

9. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

9.1.Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim sigurimin e kontrollit të vazhdueshëm të aktiviteteve të projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, verifikimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi. Monitorimi synon identifikimin në kohë të çdo ndikimi të mundshëm

negativ në mjedis dhe ndërmarrjen e masave korigjuese përkatëse në rast të devijimeve nga kushtet e lejuara. Ai do të realizohet gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të impiantit, me theks të veçantë në monitorimin e pluhurit, zhurmës, tokës, ujërave dhe menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me natyrën e aktivitetit industrial.

9.2.Gjendja mjedisore para fillimit të projektit

Gjendja mjedisore para fillimit të projektit karakterizohet nga një zonë me përdorim industrial ose gjysmë -natyror, me vegjetacion të rrallë dhe pa burime të ndjeshme mjedisore në afërsi të drejtpërdrejtë. Cilësia e ajrit, tokës dhe ujërave vlerësohet si e mirë dhe pa ndotje të konsiderueshme. Kjo gjendje shërben si bazë krahasuese për vlerësimin e ndryshimeve eventuale që mund të shfaqen gjatë realizimit dhe operimit të projektit.

9.3.Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Parametrat kryesorë që do të monitorohen përfshijnë:

- cilësinë e ajrit me fokus në pluhurin e gjeneruar nga aktivitetet mekanike dhe qarkullimi i mjeteve,
- nivelet e zhurmës nga pajisjet teknologjike dhe mjetet transportuese,
- gjendjen dhe mbrojtjen e tokës në zonën e impiantit,
- menaxhimin e ujërave të reshjeve dhe parandalimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore,
- menaxhimin e mbeturinave inerte, komunale,
- gjendjen teknike dhe sigurinë e pajisjeve të impiantit.

Monitorimi i këtyre parametrave mundëson vlerësimin e vazhdueshëm të ndikimeve mjedisore dhe ndërmarrjen në kohë të masave korigjuese, me qëllim që ndikimet të mbahen brenda niveleve të lejuara dhe të kontrolluara.

9.4.Vendet, mënyra dhe shpeshësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Matjet do të kryhen brenda zonës së impiantit dhe, sipas nevojës, në pikat përreth tij. Gjatë fazës së ndërtimit, monitorimi do të realizohet më shpesh për shkak të intensitetit të aktiviteteve, ndërsa gjatë operimit do të kryhet në intervale periodike. Matjet do të realizohen përmes pajisjeve të certifikuara dhe, sipas rastit, nga operatorë të autorizuar.

9.5.Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Raportet e monitorimit do të përfshijnë rezultatet e matjeve, analizën e të dhënave, krahasimin me vlerat kufitare dhe rekomandimet për masa shtesë, nëse kërkohen. Raportimi

do të bëhet në baza periodike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe kusht eve të përcaktuara nga autoritetet kompetente .

9.6.Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Zbatuesi i projektit është i detyruar të sigurojë transparencë dhe të informojë publikun për rezultatet e monitorimit mjedisor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Informimi do të realizohet përmes raporteve zyrtare dhe, sipas nevojës, përmes njoftimev e publike. .

9.7.Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis

Duke qenë se lokacioni i projektit ndodhet në afërsi të kufirit shtetëror me Republikën e Maqedonisë së Veriut, është marrë në konsideratë mundësia e ndikimeve ndërkufitare, kryesisht në aspektin e cilësisë së ajrit dhe zhurmës. Bazuar në natyrën e projektit dhe procesin teknologjik mekanik, nuk parashikohen ndikime të drejtpërdrejta dhe të matshme ndërkufitare në mjedis. Megjithatë, monitorimi mjedisor do të realizohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat e mira, duke përfshirë:

- monitorimin periodik të pluhurit dhe zhurmës brenda dhe në kufijtë e lokacionit;
- zbatimin e vazhdueshëm të masave për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës;
- reagim të menjëhershëm në rast të ankesave apo vërejtjeve të mundshme nga palët përreth.

Në rast se gjatë operimit identifikohen ndikime që mund të kenë karakter ndërkufitar, investitori do të bashkëpunojë me autoritetet kompetente përkatëse, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. Në përfundim, projekti nuk kërkon program të veçantë ndërkufitar monitorimi, por monitorimi mjedisor i rregullt siguron parandalimin dhe menaxhimin e çdo ndikimi të mundshëm në mjedisin përreth.

10. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

10.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani i Menaxhimit Mjedisor synon të sigurojë mbrojtje efektive të mjedisit gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe përfundimit të aktivitetit të impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe do të zbatohen masa për reduktimin e pluhurit dhe zhurmës, mbrojtjen e tokës dhe parandalimin e ndotjes së ujërave, si dhe menaxhimin e rregullt të mbeturinave ndërtimore dhe komunale. Aktivitetet do të zhvillohen në mënyrë të orga nizuar dhe vetëm brenda parcelës së projektit. Gjatë fazës së operimit, fokusi do të jetë në funksionimin e sigurt dhe të kontrolluar të impiantit, mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve teknologjike, zbatimin e masave

për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës, si dhe menaxhimin e mbeturinave inerte. Aktiviteti zhvillohet kryesisht përmes proceseve mekanike, pa përdorim të substancave kimike të rrezikshme dhe pa gjenerim të ujërave të ndotura teknologjike. Në rast të përfundimit ose ndërprerjes së aktivitetit, do të zbatohet rehabilitimi i lokacionit, duke rregulluar sipërfaqet e prekura dhe duke rikthyer zonën në një gjendje të qëndrueshme dhe të sigurt për mjedisin.

10.2. Pajtushmeria me pëlqim mjedisor

Zbatimi i projektit do të bëhet në përputhje të plotë me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pëlqimin mjedisor, si dhe me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse, rrjedhin nga pëlqimi mjedisor, duke përfshirë:

- zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore;
- monitorimin e rregullt të ndikimeve në mjedis;
- raportimin periodik pranë institucioneve kompetente;
- bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse dhe inspektuese.

Çdo ndryshim eventual në teknologji, kapacitet ose mënyrë operimi do të trajtohet në përputhje me procedurat ligjore përkatëse dhe do të njoftohen autoritetet kompetente.

10.3. Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore, kompania synon zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit mjedisor, në përputhje me parimet e standardit ISO 14000. Zbatimi i këtij sistemi do të kontribuojë në:

- identifikimin dhe kontrollin sistematik të ndikimeve mjedisore;
- përmirësimin e efikasitetit operativ;
- rritjen e përgjegjësisë mjedisore të personelit;
- përmbushjen më të lartë të kërkesave ligjore dhe institucionale.

Zhvillimi i sistemit të menaxhimit mjedisor do të realizohet në mënyrë graduale, duke u përshtatur me natyrën dhe shkallën e aktivitetit të projektit.

11. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

11.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së

Ky projekt për ndërtimin dhe operimin e impiantit për shfrytëzim , përpunimin, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror është hartuar duke marrë parasysh kërkesat e Ligjit Nr. 08/L - 181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2025 , me qëllim që të sigurohet vlerësim i plotë dhe realist i ndikimeve mjedisore. Karakteristikat kryesore të projektit që kanë ndikuar në përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së këtij raporti të VNM -së janë natyra mekanike e procesit teknologjik, kapaciteti i planifikuar i prodhimit, shtrirja hapësinore e impiantit dhe afërsia e loka cionit me kufirin shtetëror. Procesi nuk përfshin djegie, procese kimike apo përdorim të substancave të rrezikshme, çka kufizon ndjeshëm potencialin për ndotje të ajrit, ujit dhe tokës. Gjithashtu, projekti nuk gjeneron ujëra të ndotura teknologjike, nuk kërkon trajtim të mbeturinave në lokacion dhe mbështetet në infrastrukturë ekzistuese të zhvilluar, gjë që ka ndikuar në fokusimin e raportit në aspektet kryesore të ndikimit, si pluhuri, zhurma dhe ndikimet lokale në mjedis dhe komunitet. Informacionet shitesë të përfshira në këtë raport synojnë të sigurojnë transparencë, qartësi dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore, duke mundësuar vlerësim të saktë të ndikimeve dhe përcaktim të masave adekuate për mbrojtjen e mjedisit gjatë të gjitha fazave të projektit.

12. BURIMET E TË DHËNAVE

12.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM -së

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- TE DHËNAT NGA INVESTITORI,
 - 1.-PLANI -ZHVILLIMOR -KOMUNAL -2025 -2033 -MIN.PDF
 - KOSOVO GEOPORTAL
 - NOVA BERDA, - GOOGLE MAPS
 - LIGJI NR. 08/L -181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (RKS -GOV .NET)
 - UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR.04/2025 PËR PËMBAJTJEN,
- METODOLOGJINË DHE PËRPUTHSHMËRINË E RAPORTIT ME KËRKESAT LIGJORE ,

PRAKTIKAT E ZBATUESHME DHE ASPEKTET E TJERA TEKNIKE TË RAPORTIT
- UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 13/2013 PËR KATALOGUN SHETËTOR TË
MBETURINAVE